

VËRTETËSIA

BOTIM I XHEMATIT MUSLIMAN AHMEDIA TË SHQIPËRISË

PRANVERË 2020

WWW.ALISLAM.AL

NR. 10



Komentim i ajetit:
Ihdinas-siratal-mustekim

9

Përse besoj në fenë
islame?

18

Namazi - esenca dhe
filozofia e tij

25

Përqendrimi në namaz

64



Mesih i Premtuar & IMAM MEHDI

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. kishte paralajmëruar se Mesihu i Premtuar do të zbrësë pranë një minareje të bardhë, në lindje të Damaskut. Kjo profeci u përmbush me ardhjen e Hazret Mirza Ghulam Ahmedit ^{s.a.s.} në Kadian të Indisë, një qytezë që ndodhet pikërisht në lindje të Damaskut.



Hazret Mirza Ghulam Ahmedi ^{s.a.s.}, Mesih i Premtuar dhe Imam Mehdi lindi në vitin 1835 në një familje fisnike në Kadijan të Indisë. Që në moshën e re, ai shfaqti interes të veçantë në fe dhe ushqu dashurinë për Profetin Muhammed ^{s.a.s.}. Ai dallohej për fisnikërinë, dashamirësinë dhe vendosmërinë e tij. Me kalimin e kohës, njohuria dhe botëkuptimi i tij i besimit dhe zbatimit të tij në shoqëri u thelluan. Duke qenë një musliman i devotshëm, ai besonte fuqimisht se të gjitha fetë janë të vërteta për sa i përket origjinës së tyre, megjithatë në rrjedhën kohore ato u janë shmangur mësimëve burimore. Ai mbrojti dinjitetin e besimit dhe vërtetoi se ai është bashkëkohor dhe u përgjigjet sfidave të kohës.

Përpjekjet e tij në përkrahje të besimit u shpërblyen prej Allahut dhe ai nisi të merrte shpallje të drejtpërdrejta prej Tij, një bekim hyjnor që e shoqëroi deri në fund të jetës.

Misioni i tij ishte të shquante të vërtetat që përmban çdo fe, si dhe të rigjallëronte mësimet e Islamit. Përmes këtij misioni, ai hodhi themelet për t'i bashkuar njerëzit dhe për të vendosur paqe e harmoni të përhershme.

Më 1889, sipas urdhrat hyjnor, Hazret Mirza Ghulam Ahmedi ^{s.a.s.} themeloi Xhematin Musliman Ahmedia. Kjo bashkësi që tashmë është shumëfishuar në numër e në shtirje është angazhuar fuqimisht për të përçar mesazhin e Islamit deri në skajet e botës.

Gjatë periudhës në të cilën jetoi, Islami ishte nën shënjestër të sulmeve armiqësore nga të gjitha anët dhe muslimanët në përgjithësi ishin në rënie të skajshme shpirtërore, duke

pasur një besim të dyshimtë dhe krejtësisht sipërfaqësor. Ai ndërmori një fushatë të jashtëzakonshme për t'i treguar botës fytyrën e bukur dhe të vërtetë të fesë islame. Ndër përpjekjet e tij të çmuara e madhore, mund të përmendim: mbi tetëdhjetë libra, të cilët janë përkthyer në më shumë se 60 gjuhë të botës si "Filozofia e mësimëve islame", "Brahin-e-Ahmedia" etj., qindra ligjërata me njohuri të thella të mistikës e debate të shumta fetare, të cilat argumentojnë më së miri se feja islame është një fe e gjallë, nëpërmjet së cilës njeriu mund të lidhë kontakt me Krijuesin dhe mund të komunikojë me Të.

Shumica nga veprat e tij janë shkruar në gjuhën urdu, disa janë në gjuhën arabe e disa të tjerë edhe në gjuhën perse. Ai gjithashtu provoi se mësimet e Kuranit Famëlartë dhe ligji i fesë islame kanë fuqinë të ngrenë e të përsosin nivelin moral, intelektual dhe shpirtëror të njeriut. Ai deklaroi se Zoti i Madhërishtëm e ka katurat atë si Mesih dhe Imam Mehdi, siç ishte përmendur në profecitë e Biblës, të Kuranit Famëlartë dhe të haditheve të Hazret Profetit Muhammed ^{s.a.s.}.

Nga 1889 deri 1908 kur ai ndërroi jetë, mijëra njerëz iu bindën atij dhe lidhën besëlidhje me të. Ky bekim vazhdon të përhapet përmes kalifëve (zëvendësve) të tij.

Aktualisht Hazret Mirza Masrur Ahmedi (Allahu e ndihmoftë fuqimisht) është udhëheqësi botëror i Xhematit Musliman Ahmedia dhe Kalifi i Pestë i Mesihut të Premtuar^{s.a.s.}. Ky Xhemat sot është përhapur në më shumë se 205 vende të botës dhe përbëhet nga miliona anëtarë.

Falja



Dhe çka ju është dhënë juve është kënaqësia e përkohshme e kësaj bote, e ajo që është tek Allahu është më e mirë dhe më e qëndrueshme për ata që e pranojnë besimin dhe i mbështeten vetëm Zotit të tyre. Dhe ata të cilët ruhen prej mëkateve të mëdha e prej veprave të turpshme dhe kur zemërohen, ata falin. Dhe ata që e dëgjojnë thirrjen e Zotit të tyre dhe e falin namazin dhe e rregullojnë çdo çështje të tyre me konsultime reciproke, dhe që shpenzojnë prej asaj që Ne u japim. Dhe që kur sillen padrejtësisht, e mbrojnë veten.

ISLAMI, KURANI, 42:37-40.



Musai, djali i Imranit tha: “O Zoti im! Cili është shërbëtori më i denjë sipas vlerësimit Tënd?”. Iu tha “Ai që fal edhe pse ka fuqi e pushtet”.

ISLAMI,

PROFETI MUHAMMED ^{S.A.S}

IMAM BEJHLAKI, “SHUABUL-IMAN”,

HADITHI NR. 8327.



Nëse Zoti i Madhërishtëm nuk do të kishte dashur t'i falte penduesit duke mëshiruar ata, përse duhet ta nguliste ndjenjën e faljes në natyrën njerëzore? Sigurisht, vetia më e lartë e njeriut është t'u lirojë fajtorëve nga detyrimi dhe t'u falë gabimin... A nuk është e vërtetë që dobësia e njeriut është një helm vdekjeprurës dhe emri i Zotit et-Tevvab d.m.th. Pendimpranues i përgjigjet pikërisht kësaj dobësie njerëzore? Me të vërtetë, falja është një vepër që nëse shfaqet në kohën e duhur, e pranon edhe natyra njerëzore.

ISLAMI, MESIHU I PREMTUAR⁴⁵,

ÇESHMA-E-MARIFET, RUHANI

KHAZATIN, V. 23, F. 192-193.



Pra, nëse e sjell dhuratën tënde për ta kushtuar në alter e aty të bie në mend se yt vëlla ka diçka kundër teje, lëre dhuratën tënde aty para alterit, shko e pajtohu më parë me vëllain tënd e pastaj eja e kushtoje dhuratën tënde!

KRISHTËRIMI, BIBLA, MATEU

5:23-24.



Nuk do të hakmerresh dhe nuk do të mbash mëri kundër bijve të popullit tënd, por do ta duash të afërmin tënd si veten tënde. Unë jam Zoti.

JUDAIZMI, TANAKH, LEVITIKU 19:18.



Ai që hakmerret ose mban mëri i ngjan atij njeriu i cili duke punuar me thikë ka vrarë njëren dorë, e tani hakmerret duke vrarë dorën tjetër.

JUDAIZMI, JERUSALEM TALMUD,

NEDARIM 9:4.



Aty ku është falja, gjendet edhe Zoti.

SIKIZMI, ADI GRANTH,

SHELOK, KEBIR, F. 1372.

VËRTETËSIA

9 Komentim i ajetit

El-hamdu lil-lāhi rabbil-ālemīn

Vërtetësia vijon t'ju sjellë shqipërimin e Et-Tefsīr-ul-Kebīr (komentimit të madh), një prej komentimeve më të thella e të argumentuara, të shkurara ndonjëherë.

HAZRET MIRZA BASHIRUDDIN MAHMUD AHMED ^{R.A.},
UDHËHEQËSI I DYTË I XHEMATIT MUSLIMAN AHMEDIA

16 Fatkeqësitë nuk do të largohen, derisa njerëzit nuk e largojnë kokëfortësinë e tyre

HAZRET MIRZA GHULAM AHMED ^{A.S.}
MESIH I PREMTUAR DHE IMAM MEHDI

18 Përse besoj në fenë islame?

Dëshmia personale e Hazret Mirza Bashiruddin Mahmud Ahmedit^{r.a.} që tregon arsyet përse besonte në fenë islame, si përgjigje ndaj pyetjes, që i bëri radio "Bombay".

HAZRET MIRZA BASHIRUDDIN MAHMUD AHMED ^{R.A.},
UDHËHEQËSI I DYTË I XHEMATIT MUSLIMAN AHMEDIA

25 Namazi - esenca dhe filozofia e tij

HAZRET MIRZA GHULAM AHMED ^{A.S.}
MESIH I PREMTUAR DHE IMAM MEHDI

32 Islami dhe Evropa - a është një përplasje qytetërimesh?

Fjalimi i mbajtur më 22 tetor 2019 në hotel Adlon në Berlin, Gjermani.

HAZRET MIRZA MASRUR AHMED ^{A.B.A.} KALIFI I PESTË
I MESIHUT TË PREMTUAR, UDHËHEQËSI BOTËROR I
XHEMATIT MUSLIMAN AHMEDIA

46 Etika dhe rëndësia e leximit të Kuranit

Përmbledhje nga hutbja e mbajtur më 21.10.2005.

HAZRET MIRZA MASRUR AHMED ^{A.B.A.} KALIFI I PESTË,
UDHËHEQËSI BOTËROR I XHEMATIT MUSLIMAN
AHMEDIA

52 Çfarë janë engjëjt ose melekët?

HAZRET MIRZA TAHIR AHMED ^{R.A.},
UDHËHEQËSI I KATËRT I XHEMATIT MUSLIMAN
AHMEDIA

56 Emrat e Allahut

Vërtetësia ju sjell kuptime të thella që përmbajnë atributet e Allahut

64 Përqendrimi në namaz

Namazi përmban në vetvete disa kushte, të cilat nëse vihen në zbatim, mund të na ndihmojnë për të arritur përqendrim në namaz.

HAZRET MIRZA BASHIRUDDIN MAHMUD AHMED ^{R.A.},
UDHËHEQËSI I DYTË I XHEMATIT MUSLIMAN AHMEDIA

73 Çfarë është agjërimi?

Një përkufizim i shkurtër i njërës prej pesë shtyllave të Islamit, në bazë të thënieve profetike.



32



9



Eseja e titulluar “*Filozofia e mësimeve të Islamit*” është shkruar në gjuhën urdu nga Hazret Mirza Ghulam Ahmed a.s., Mesihu i Premtuar dhe Imam Mehdiu, si përgjigje ndaj ftesës së Z. Svami Sad’hu Shogan Çander, i cili organizoi Mbledhjen e Madhe të Feve, në Town Hall të qytetit Lahor në datat 26 – 29 dhjetor të vitit 1896. Dijetarët muslimanë, të krishterë, arjë dhe të feve të tjera ishin ftuar për të përfaqësuar fenë e tyre përkatëse. Atyre u ishte caktuar të ligjëronin rreth pesë pyetjeve të kërkuara në bazë të Librit që ata besonin si Hyjnor:

1. **Gjendjet trupore, morale dhe shpirtërore të njeriut**
2. **Cila është gjendja e njeriut pas kësaj jete, pra në botën vijuese?**
3. **Cili është qëllimi i vërtetë i qenies së njeriut në këtë botë dhe si mund të përmbushet ai qëllim?**
4. **Si ndikojnë veprat te njeriu në këtë botë dhe në botën vijuese?**
5. **Cilat janë mjetet për të arritur dijen dhe njohjen Hyjnore?**

Lexoni online:

<https://www.ahmadiyya-islam.org/al/librat/>

ose blini këtu:

<https://www.ahmadiyya-islam.org/al/kontaktoni/>

VËRTETËSIA

KRYEREDAKTOR

Samad Ghorri

ZËVENDËSREDAKTOR

Shahid Butt

REDAKTOR GJUHËSOR

Besmir Yvejsi

ANËTARË

Jinahuddin Saif, Bujar Ramaj, Imer Gjergji

GRAFIKA

Shahid Butt

SHTYPUR NË SHTYPSHKRONJËN

RanaPoster.de Druckerei

Robert-Perthel-Str. 15

50739 Köln-Bilderstöckchen, Deutschland

ADRESA POSTARE

NË SHQIPËRI:

Xhemati Musliman Ahmedia i

Shqipërisë, pranë Vodafonit,

Rr. "Pavarësia" Km. 1, Mëzez,

Kutia Postare 8176, Tiranë,

Shqipëri

NË KOSOVË:

Xhemati Musliman Ahmedia i Kosovës

Rr. "Holger Pedersen",

Lagjja e Spitalit,

Kutia postare 43, Prishtinë

Kosovë

NË GJERMANI:

Albanian Desk

Barendorfer Bruch 15,

58640 Iserlohn, Deutschland

KONTAKT

M +355 67 216 8054, (0) 694644888

M +377 44 817 813

T +355 42 391 080

WEBSITE

www.alislam.al

El-hamdu lil-lāhi rabbil-ālemīn LAVDIA ËSHTË E ALLAHUT

El-Fatiha, ajeti 2

Vërtetësia vijon t'ju sjellë shqipërimin e Et-Tefsīr-ul-Kebīr:
(komentimit të madh), shkruar nga Hazret Mirza Bashiruddin
Mahmud Ahmed ^{r.a.}, udhëheqësit të dytë të Xhematit Musliman
Ahmedia. Ky është një prej komentimeve më të thella e të
argumentuara, të shkurara andonjëherë.



الحَمْدُ لِلَّهِ *El-hamdu il-lah*

Arsyeja pse u përdor emri dhe jo folja

Nuk u tha: “lavdëroj ose lavdërojmë Allahun”, por thuhet “lavdia është e Allahut” dhe ky ndryshim sjell shumë kuptime. Duke përdorur jo foljen, por emrin në trajtën e shquar, Kurani Famëllartë përfshiu çdolloj lavdërimi, qoftë të njohur a të panjohur për njerëzit. Pra, të gjitha lavdërimet që mund të bëjnë krijesat ose që i bëjnë, i takojnë Zotit të Madhërishëm. Nuk ka asnjë të mirë që Ai nuk e zotëron dhe nuk ka asnjë të keqe, së cilës Ai nuk i qëndron larg. Ky ajet gjithashtu tregon se edhe lavdërimin ndaj krijesave vetëm Zoti i Madhërishëm mund ta bëjë siç duhet, sepse Ai është Njohësi i të fshehtave. Robi lëvdon robin tjetër, por nganjëherë edhe jo të drejtë. Nganjëherë nuk arrin ta lavdërojë aq sa ka cilësitë tjetri dhe nganjëherë e lavdëron më shumë sesa duhet. Andaj, lavdërimi i vërtetë është ai që bën Zoti i Madhërishëm. Thamë për lavdërimin e njerëzve në raport me njëri-tjetrin, por njeriu shpesh gabon edhe në cilësimin e vetvetes. Por ajo që thotë Zoti për robin nuk mbetet as e mangët dhe as e tepërt. Ajeti në fjalë po të fillonte me foljen “lavdëroj” ose “lavdërojmë”, nuk mund t’i kishte këto kuptime.

Gjithashtu, nëse ky ajet do të fillonte me folje, pra, “lavdëroj Allahun...” do të nënkuptohej që njeriu e ka aftësinë t’i kuptojë të gjitha cilësitë e Zotit të Madhërishëm, gjë që nuk mund të jetë e vërtetë. Njeriu është i kufizuar dhe ai lavdëron vetëm në bazë të dijes së tij, kurse Zoti i Madhërishëm është i pakufizuar dhe zotëron cilësi të panumërta për t’u lavdëruar.

Shkurt, fjala el-hamdu “lavdia” i përfshin të gjitha kuptimet që mund të kenë fjalët “lavdëroj” ose “lavdërojmë”, madje edhe kuptime të tjera. Andaj, ishte e nevojshme që kjo sure e shkurtër që është përmbledhja e të gjitha kuptimeve të Kuranit, të fillonte me fjalët El-Hamdu lil-lah “Lavdia është e Allahut”.

Kurani Famëlartë sigurisht që përmend edhe lavdërimin e Zotit nga ana e krijesave, siç thotë:

وَنَحْنُ نُسَبِّحُ بِحَمْدِكَ

“Dhe ne të përkujtojmë Ty me lavdërimin Tënd”.¹


Por, në asnjë ajet të Kuranit nuk përmenden fjalët si “lavdëroj” ose “lavdërojmë” kur si kryefjalë janë krijesa. Janë përdorur fjalët jusebbihu “përkujton” nusebbihu “përkujtojmë”, nukaddisu “përmendim shenjtërinë Tënde”. Mendoj se kjo përzgjedhje fjalësh ka një kuptim, që robi nuk e rrok dot lavdërimin e plotë. Pavarësisht se në hadithe nuk është marrë parasysh kjo gjë, dihet që fjalët kur janë në librin e Zotit të Madhërishëm kanë një nivel tjetër kuptimor dhe kur vijnë nga robi kanë një tjetër nivel kuptimor. Një fjalë të caktuar kur e thotë robi, nuk merr kuptime aq të gjithanshme, sa kur e thotë Zoti i Madhërishëm, sidomos kur Ai e thotë në Librin dhe në Sheriatin e Tij.

لِلَّهِ *Lil-lahi* “e Allahut”

Li në arabisht është parafjalë pronore, pra përdoret për të treguar pronësinë. Kjo pjesë sqaron se pavarësisht se lavdërimi bëhet edhe ndaj njerëzve, në të vërtetë dhe në mënyrë absolute ai i takon Allahut të Madhërishëm, kurse çdokush dhe çdo gjë tjetër përveç Tij, ka lavdërim relativ e të dhuruar. Kjo sepse vetitë e mira që ka njeriu, nuk i ka të tijat, por të dhuruara prej Zotit të Madhërishëm. Andaj, çdo lavdërim që i bëhet njeriut, në të vërtetë i përket Zotit të Madhërishëm.

Dhjetë kuptime të ajetit “*El-Hamdu lil-lah...*”

Disa kuptime të këtij ajeti shënohen sa vijon:




1) Krijuesi i gjithësisë është i pastër nga çdo e metë dhe zotëron çdo të mirë.


2) Ai është në dijeni të plotë të të gjitha krijesave deri në gjenezën e tyre dhe përveç Atij, askush tjetër nuk zotëron dije të plotë qoftë edhe për një gjë të caktuar. Kjo është e vërtetuar edhe nga zhvillimi i shkencës. Plot shkencëtarë merren me zbulimin e gjërave të ndryshme, por askush prej tyre nuk e ka zbuluar dot deri në fund qoftë edhe një gjë të vetme. Për çdo gjë bëhen zbulime të reja përditë.

3) Zoti do të zotëronte lavdërimin absolut vetëm nëse do të ishte edhe Rabbi (Krijuesi) i botëve, përndryshe jo. Andaj, është e nevojshme që ashtu siç sistemi lëndor i Tij është vënë në dobi të gjithkujt, në të njëjtën mënyrë, edhe sistemi i Tij shpirtëror të mbulojë çdokënd dhe asnjë vend e asnjë popull të mos privohet nga mjetet e zhvillimit shpirtëror. Kështu që, nëse një shpallje e caktuar është e veçuar për një popull të caktuar, është e nevojshme të zbresë shpallje më vite për popujt e tjerë. Dhe kur popujve të tjerë nuk u zbret shpallje më vite, duhet të zbresë një shpallje për udhëzimin e krejt botës. (Andaj, feja që beson se shpallja ka zbritur vetëm për udhëzimin e popullit të vet, ose që shpëtimi është vetëm e drejta e tyre dhe jo e të tjerëve, e ka gabim).

4) Të gjitha vetitë e mira që kanë njerëzit, janë të dhuruara prej Zotit të Madhërisëm, andaj, për çdo të mirë që ata bëjnë, lavdërimi i vërtetë i takon Zotit.

5) Duke e lidhur lavdinë me Rabbil-‘alemin-in (Krijuesin e botëve), kjo sure tregon që gëzimi i vërtetë i njeriut duhet të jetë me shfaqjen e cilësisë hyjnore “Krijuesi i botëve”. Ai që gëzohet vetëm për dobinë e vet dhe nuk shqetësohet





kur sheh humbjen që pëson bota, nuk e kupton mësimin e Islamit. Gëzimi i vërtetë arrihet kur e gjithë bota gjen qetësi.

Ajeti pohon se evolucioni i krijimit ka ndodhur


6) Allahu është Rabbi (Krijuesi dhe Zhvilluesi) i botëve. Kjo tregon se çdo gjë tjetër përveç Allahut, është nevojtare e krijimit dhe e zhvillimit, që do të thotë se duhet të ndjekë ligjin e evolucionit për mbijetesën e vet. Ky ajet tregon se nuk ka gjë në botë që ka të njëjtin fillim e mbarim dhe se përveç Zotit të Madhërishëm, çdo gjë është e ndryshueshme dhe zhvillohet shkallazi nga një gjendje më e ulët, deri tek më e larta. Kjo dukuri provon dy gjëra: së pari, çdo gjë përveç Zotit të Madhërishëm është krijesë dhe nuk është e mëvetësishme, derisa zhvillohet dhe pëson ndryshime. Së dyti, çështja e evolucionit është e saktë. Çdo gjë ka evoluar nga gjendja më e ulët deri tek më e larta, qoftë njeriu, apo kafshët, qoftë bimësia, apo sendet, sepse Rabbil-‘ālemīn do të thotë: Zoti sjell çdo gjë nga gjendja më e ulët deri tek e larta. Pra, tregon që gjithçka që ekziston në këtë botë, ndjek rrugën e evolucionit.


7) Mësuam se evolucioni ndodh në kohëra dhe në etapa të ndryshme, sepse fjala rabb do të thotë:

إِنشَاءُ الشَّيْءِ حَالًا فَحَالًا إِلَى حَدِّ التَّامِّ

“Të krijosh diçka dhe ta çosh atë shkallë-shkallë deri në përsosmërinë e saj” (pra, jo ta përsosësh përnjëherë).²

8) Gjithashtu mësuam se evolucioni nuk është kundër ekzistencës së Zotit, sepse thotë: “Lavdia është e Allahut, Rabbit të botëve”, pra krijimi në etapa të ndryshme nuk bie ndesh me praktikën e Zotit, madje kjo mënyrë e krijimit





e bën Atë të Lavdishëm. Andaj, përpara fjalëve Rabbil-alemin (Zoti i botëve), thuhet El-Hamdulil-lah “Lavdia është e Allahut”.

Njeriu është krijuar për përparime të pakufishme


9) Ky ajet gjithashtu tregon se njeriu është krijuar për përparime të pakufishme, sepse thotë se lavdia është e Allahut se Ai e përsos çdo krijesë duke e çuar atë deri në gjendjen më të lartë. Kjo tregon se derisa të ekzistojnë krijesat, gjithmonë do të ketë një gjendje më të avancuar sesa e tanishmja.

10) Dhe e fundit, duke filluar Kuranin Famëlartë me suren El-Fatiha si përmbledhje e kuptimeve kuranore, dhe duke e filluar El-Fatihanë me fjalët “Lavdia është e Allahut, Zotit të botëve”, tregon se koha e lavdisë së përsosur të Zotit, tani ka filluar, sepse Islami përfaqëson Zotin e botëve dhe është një fe për të gjithë botën. Në këtë mënyrë, me ardhjen e Islamit, është krijuar një bashkim në botën shpirtërore, siç vërejmë bashkimin në botën lëndore. Përpara Islamit, profetët vinin për popuj të caktuar. Ithtarët e një feje të caktuar me naivitete mohonin mesazhin e profetëve të tjerë. Për shembull, hindutë deklarorin se njihnin Permshverin dhe jo Jehovahin, ndërsa hebrenjtë e përqeshnin Permshverin. Por me ardhjen e Islamit, u krijua një fe e vetme për të gjithë botën dhe edhe indianët, edhe kinezët, edhe egjiptianët, edhe persët, edhe lindorët edhe perëndimorët, të gjithë filluan ta lavdërojnë Zotin dhe u pranua se jo çdo popull ka Zotin e vet, por të gjithë popujt kanë një Zot të Vetëm.


SHËNIME

1. Kurani Famëlartë 2:31.

2. Ragib el-Isfahani, “*El-Mufredat fi Garibil-Kuran*”, Redaktor: Muhammed Sejjid Kejlani, shtëpia botuese “Darul-Ma’rifeh”, Liban, pa vit botimi, f. 184.



Dhjetë argumente për ekzistencën e Zotit



Hazret Mirza Bashir-ud-Din
Mahmud Ahmed^{r.a.}



Ka një debat të ashpër dhe të ndezur mes ateistëve dhe teistëve për ekzistencën e Zotit, gjë që është shenjë e mirë e një fryme intelektuale të shëndetshme e të gjallëruar. Diskutimi mbi ekzistencën e Zotit duhet të fillojë me pranimin se barra e provës qëndron te teistët, domethënë te ata që besojnë në Zot.

Botuar fillimisht në mars të vitit 1913 në revistën “*Tash’beezul-Azbaan*”, libri në gjuhën urdu “*Das Dalaail Hasti Bari Ta’alaa*” (Dhjetë argumente për ekzistencën e Zotit) është i domosdoshëm për këdo që dëshiron të kuptojë aspektin më themelor të besimit. Në këtë libër Hazret Mirza Bashiruddin Mahmud Ahmed ^{r.a.}, Kalifi i Dytë i Mesihut të Premtuar, trajton një argument kryesor të ateistëve se nëse Zoti ekziston pse nuk mund ta shohim Atë. Më pas, autori parashtron dhjetë argumente nga Kurani Famëlartë për të treguar me forcë bindëse se ekzistenca e Zotit mund të vërtetohet me siguri të plotë dhe në një mënyrë që nuk mund të hidhet poshtë.



Hazret Mirza Ghulam Ahmed ^{a.s.}

Mesih i Premtuar dhe Imam Mehdi



Fatkeqësitë nuk do të largohen, derisa njerëzit nuk e largojnë kokëfortësinë e tyre

Njerëzit duhet ta kenë parasysh ahiretin. Duhet që të kenë drojë, përpara se t'u vijë ndëshkimi. Shikoni si përfunduan populli i Lutit dhe popuj të tjerë. Dikush edhe sikur e ka zemrën gur, duhet që ta qortojë atë e t'i japë mësimin e përlulesisë dhe të përgjërimit përpara Zotit. Kjo është shumë e rëndësishme për anëtarët e Xhematit tonë, sepse atyre u mundësohet njohja e freskët ndaj Zotit. Ai që bën dua për njohjen e Zotit, por nuk e praktikon atë, bën vetëm llafe.

Anëtarët e Xhematit tonë nuk duhet të mbeten të shkuajdesur duke parë shkuajdesjen e të tjerëve, dhe nuk duhet të mbeten të ftohtë, duke vërejtur ftohtësinë e të tjerëve. Njeriu mban shumë shpresa e dëshira. Por kush mund ta dijë caktimin e së padukshmes?! Jeta nuk ecën në bazë të shpresave tuaja. Shpresat ndjekin tjetër linjë, dhe caktimet ndjekin tjetër linjë dhe pikërisht kjo linja e dytë është e vërteta. Mbajeni mend! Te Zoti e ka të shkruar të saktë të gjithë biografinë e njeriut. Kurse vetë njeriu nuk mban mend se çfarë gjërash janë shkruar aty. Prandaj, vazhdimisht duhet ta zgjoni zemrën”.

“Është për të ardhur keq që, pavarësisht se ranë fatkeqësi, por sërish nuk u largua nga njerëzit mburrja dhe kokëfortësia e tyre, në përgjithësi. Sinqerisht ju them të vërtetën, fatkeqësitë nuk do t'u largohen njerëzve, derisa ata nuk do të largojnë kokëfortësinë e vet. Unë shoh që njerëzit nuk janë të gatshëm për të bërë pajtim të plotë me Zotin e Madhërishtëm. Këtë e pamë gjatë thatësirës që ra së fundmi. Në të kaluarën, njerëzit i trembte thjesht një dekret që mund të shpallej nga Meka ose Medina. Pra, kur dikush thoshte se kështu erdhi një dekret nga Meka e Shenjtë, njerëzit trembeshin. Por, tani nuk tremben as duke i parë me sy fatkeqësitë. Mendimi im është që derisa njerëzit nuk kthehen tërësisht drejt Zotit, nuk do t'u ndryshojë fati. Zoti thotë në Kuranin e Shenjtë:

إِنَّ اللَّهَ لَا يُغَيِّرُ مَا بِقَوْمٍ حَتَّى يُغَيِّرُوا مَا بِأَنْفُسِهِمْ

“Sigurisht, Allahu nuk ndryshon çfarë ka një popull, derisa ata ta ndryshojnë çfarë kanë në veten e tyre”. (Er-Ra'd 13:12)”

(“Melfuzat”, vëll. 1, f. 152)



An aerial photograph of a coastline. A large bay is visible, with a prominent headland on the right side. The water is a deep blue, and the sky is a pale, hazy yellow. The land is rugged, with steep cliffs and some vegetation. In the bottom right corner, there are some small buildings and a road.

Përse besoj në fenë islame?

Hazret Mirza Bashiruddin Mahmud Ahmed r.a.



Radio “Bombay” më ka kërkuar që të tregoj se pse unë besoj në fenë islame. Kur i bëra këtë pyetje vetes, mora përgjigjen se besoj në vërtetësinë e kësaj feje me të njëjtin argument, në bazë të të cilit besoj edhe në vërtetësinë e gjërave të tjera të vërteta.

Pra, sipas meje, çështja kryesore e një feje është ekzistenca e Zotit. Feja që arrin të krijojë lidhje të sinqertë midis robit dhe Zotit është fe e vërtetë dhe vërtetësia e diçkaje është vetë një argument i mjaftueshëm për të pasur bindje ndaj saj. Sepse, ai që nuk e beson të vërtetën, detyrohet të besojë gënjeshtër, rrjedhimisht bëhet armik i vetvetes dhe i njerëzimit. Feja islame pohon se kjo botë ka një Krijues dhe Zot të Gjallë, i cili u manifestohet robërve të Tij edhe në kohët tona, ashtu siç u manifestoi në parë tanë në të kaluarën. Ky pohim mund të provohet vetëm në dy mënyra: ose t'i shfaqen mrekullitë e Zotit, kërkuesit të Tij, ose të ndjekësh dikë, të cilit i janë shfaqur shenjat e Zotit. Me bekimin e Zotit, ngaqë kam përvojë dhe vetë jam ndër ata, të cilëve Zoti i Madhërisëm shpesh u shfaqet me shenja të Tij të jashtëzakonshme, nuk më duhet ndonjë argument tjetër sepse e kam provuar vetë vërtetësinë e fesë islame. Por, për ata që ende nuk kanë një përvojë të tillë, dua të përmend disa argumente të vërtetësisë së fesë islame përveç argumentit të përvojës personale, argumente të cilat më bindën drejt kësaj feje.

Së pari, besoj në fenë islame, sepse në të gjitha çështjet që mund të ketë një fe, ajo asgjë nuk më kërkon ta besoj me zor, por për çdo gjë më jep argument. Qenia e Zotit, atributet e Tij, engjëjt, lutja, efekti i saj, caktimi dhe rrethi i tij, adhurimi dhe nevoja e tij, sheriatit dhe dobia e tij, shpallja dhe rëndësia e tij, jeta pas vdekjes, xheneti, xhehenemi, të gjitha këto feja islame i ka sqaruar gjerësisht e i ka arsyetuar me argumente shumë të forta, të cilat i duhen mendjes njerëzore për t'u bindur. Kështu që, feja islame nuk më dha vetëm një fe, por më mundësoi dijen bindëse, e cila më mbush mendjen dhe më bën të pranoj edhe nevojën e fesë.

Së dyti: Besoj në fenë islame sepse ajo nuk mbështetet vetëm në histori, por fton çdokënd ta provojë vetë dhe thotë që çdo e vërtetë mund të shqyrtohet po në këtë botë, në ndonjë mënyrë apo tjetër, dhe kështu kjo ma qetëson zemrën.

Së treti: Besoj në fenë islame sepse ajo më mëson se s'ka kontradiktë midis fjalës së Zotit të Madhërisëm dhe veprës së Tij dhe kështu ajo më liron nga grindjet që bëhen midis shkencës dhe fesë. Feja islame nuk më thotë që unë t'i anashkaloj ligjet e natyrës dhe të besoj në gjërat që janë kundër tyre. Madje, ajo mëson t'i përsiat ligjet e natyrës dhe të përfitoj nga ato, dhe më thotë se është Zoti Ai që zbriti Kuranin dhe është

po Ai që krijoi botën, kështu fjala dhe vepra e Tij nuk mund të jenë kundër njëra-tjetrës. Ndaj, të duhet ta vëzhgosh veprën e Tij për ta kuptuar fjalën e Tij dhe anasjelltas. Kështu pra, feja islame më ndrit mendjen e më qetëson.

Së katërti, besoj në fenë islame sepse ajo nuk na ndrydh emocionet, por na i drejton ato. Ajo as nuk më trajton si diçka jo të gjallë duke m'i ndrydhur emocionet e as nuk më shndërron mua në ndonjë bishë duke m'i lënë ato pafre. Madje, feja islame, si një inxhinier i zoti, arrin të grumbullojë ujëra të shumta e t'i kthejë ato në kanalizime të sistemuara në mënyrë që toka të thata të gjelbërohen e të lulëzojnë.

Në të njëjtën mënyrë edhe Islami, me ca kufizime të përshtatshme, dëshirat dhe emocionet e mia m'i kthen në morale të larta. Ai nuk më thotë që Zoti të ka dhënë një zemër që mban dashuri, por nuk ke të drejtë të kesh një bashkëshorte, ose që Zoti të ka dhënë një gjuhë që shijon dhe krijon dëshira në zemër për të ngrënë, por ti nuk mund t'i shijosh gjërat e shijshme.

Përkundrazi, feja islame më thotë: ti mund të ndiesh dashuri ndaj dikujt, por dashuria jote duhet të jetë e drejtë dhe e pastër, madje duhet t'i ruajë synimet e tua përgjithmonë përmes pasardhësve të tu; ti sigurisht mund të hash ushqime të mira e të shijshme, por brenda kufijve.

Të mos ndodhë që ti të ushqehesh mirë dhe fqinji yt të ngelet pabukë. Kështu që, feja islame m'i drejton të gjitha instinktët duke u vënë atyre kufizime të përshtatshme dhe pastaj m'i kthen ato në morale të larta dhe kështu ajo më qetëson dhe rregullon të qenët tim si njeri.

Së pesti: Besoj në Islam sepse ai jo vetëm me mua, por me të gjithë botën është sjellë me drejtësi e dashuri. Ai më mësoi të përmbush detyrat jo vetëm ndaj vetvetes, por më mëson të jem i drejtë ndaj çdo gjëje që ekziston në këtë botë dhe për këtë na ka dhënë edhe udhëzime të nevojshme. Feja islame në njërën anë ka treguar detyrimet që kanë fëmijët ndaj prindërve të tyre, duke i urdhëruar të sillen mirë me ta e madje i porosit t'i përcaktojnë pjesëtarë të trashëgimisë së tyre, dhe në anën tjetër prindërve u ka mësuar të kujdesen mirë për fëmijët e tyre, t'i edukojnë, t'i formojnë e t'u përcjellin morale të larta, të kujdesen për shëndetin e tyre dhe gjithashtu, përcaktoi që edhe fëmijët të jenë pjesëtarë të trashëgimisë së tyre.

Në të njëjtën mënyrë, feja islame dha porosi për çiftet bashkëshortore që të kenë marrëdhënie të mira me njëri-tjetrin dhe të kujdesen për emocionet e njëri-tjetrit. Sa bukur e ka shprehur Profeti i nderuar i fesë islame:

Ai që ditën sillet keq me gruan e vet

e natën bën dashuri me të, harron bukurinë e natyrshmërisë njerëzore.

Gjithashtu ai tha: Më i miri prej jush është ai që sillet mirë me gruan e tij.

Diku tjetër tha: Gruaja është delikate si qelqi. Ashtu siç përdorni me kujdes një qelq delikat, në të njëjtën mënyrë duhet të keni kujdes kur silleni me gratë.

Veç kësaj, feja islame nuk ka anashkaluar as të drejtat e vajzave. Ajo ka vënë theks të veçantë mbi arsimimin dhe edukimin e vajzave duke thënë se xheneti është i sigurt për atë që i arsimon dhe i edukon mirë vajzat e tij. Gjithashtu, feja islame edhe vajzave u jep të drejtën e trashëgimisë nga prona e prindërve.

Feja islame ka vënë drejtësi edhe ndërmjet popullit dhe udhëheqësve. Këtyre të fundit ajo u thotë se qeveria nuk është pronë e tyre, por është vetëm një amanet që u është lënë me mirëbesim. Ndaj, ata si njerëz të drejtë duhet të kryejnë punën e tyre dhe për këtë duhet të këshillohen me popullin. Ndërsa popullit feja islame i thotë: Shtetin ju ka dhënë Zoti i Madhërishëm si një bekim, prandaj, zgjidhni udhëheqës të tillë që të jenë të denjë për udhëheqje, dhe pas zgjedhjeve, bashkëpunoni me ta dhe mos u bëni rebelë, sepse përndryshe ju vetë do ta shkatërroni shtëpinë tuaj.

Feja islame ka gjykuar drejtësisht si të drejtat e punëdhënësit ashtu edhe të

punëtorit. Të parit Islami i thotë: Nëse punëson dikë, atëherë paguaje ashtu siç e meriton dhe hakun e punës duhet t'ia japësh para se t'i thahet djersa. Atë që është nën kujdesin tënd, mos e nëpërkëmb dhe mos e nënçmo, sepse ai është vëllai yt dhe Zoti ta dha që të kujdesesh për të dhe përmes tij Ai të ka forcuar. Prandaj, nga injoranca ti mos e thyej vetë forcën tënde. Edhe punëtorit feja islame i dha porosi që kur të punojë diku, të tregohet besnik dhe obligimin ta kryejë me sinqeritet dhe të mos tregohet i pakujdesshëm dhe përtac.

Po ashtu, ata që gëzojnë shëndet të mirë, feja islame i porosit: nuk duhet të keqpërdorni aftësitë tuaja; mos u bëni mizori të dobëtëve e as mos përqeshni ata që kanë dobësi fizike, madje dobësia e atyre që jetojnë në rrethin tuaj shoqëror, juve duhet t'ju ngjallë mëshirë.

Feja islame të pasurit i porosit: Keni për detyrë të kujdeseni për të varfrit dhe çdo vit t'u jepni atyre një të dyzetën nga pasuria juaj, që ajo të shpenzohet në uljen e varfërisë. Gjithashtu, kur një i varfër ka probleme financiare, nuk duhet t'ia shtoni problemet duke i dhënë kredi me kamatë. Sepse Zoti nuk ju ka dhënë pasuri që të bëni jetë sa më luksoze, por për të marrë pjesë në zhvillimin e botës, duke fituar kështu shpërblimet e të dyja botëve. Feja islame edhe të varfërve u thotë të mos shikojnë me lakmi pasurinë e të pasurit, sepse lakmia

ua nxin zemrën dhe nuk i lë të zhvillojnë aftësitë e mira. Me ndihmën e Zotit, ata duhet të fitojnë ato aftësi që ndihmojnë në zhvillim.

Veç kësaj, feja islame e këshillon shtetin që t'i ndihmojë të varfrit në përpjekjet e tyre dhe se si ai e ka për detyrë të vëzhgojë që pasuritë të mos grumbullohen vetëm në duart e disa njerëzve.

Atyre, baballarët e të cilëve fituan dinjitet dhe nder nga punët e tyre fisnike, u thotë se e keni për detyrë ta ruani dinjitetin dhe nderin e paraardhësve tuaj. Islami gjithashtu u tërheq vëmendjen të mos i nënvlerësojnë popujt e tjerë, sepse Zoti të gjithë i ka bekuar dhe të gjithë i ka bërë të barabartë. Ai u drejtohet: Ai Zot që juve ju dha nder, mund t'i japë nder më shumë popullit tjetër, andaj, nëse bëni padrejtësi ndaj dikujt, edhe ai popull mund të bëjë padrejtësi ndaj jush në të ardhmen. Kështu që, ata nuk duhet të mburren duke treguar madhështinë e tyre mbi të tjerët, por të krenohen duke i bërë të mëdhenj të tjerët, sepse i madh është ai që ngre vëllanë e tij të rrëzuar.

Feja islame thotë se asnjë shtet apo popull nuk duhet të ketë armiqësi ndaj shtetit apo popullit tjetër dhe se nuk duhet t'i marrin të drejtën dikujt tjetër. Madje, të gjithë njerëzit bashkërisht duhet të përpiqen për zhvillimin e botës. Nuk duhet të ndodhë që disa popuj, shtete apo njerëz të bashkohen për të

shtypur popuj, shtete apo njerëz të tjerë, madje ata duhet të bëjnë marrëveshje që secilin prej tyre ta ndalojnë të kryejë një akt të tillë.

Shkurt, unë shoh që në këtë botë feja islame mua e njerëzve të tjerë, kushdo e çfarëdo qofshin ata, të gjithëve na sjell paqe e lumturi. Në cilindo pozicion ta vendos veten, unë shoh që, duke i ndjekur mësimet e Islamit, nuk privohem nga rrugët e suksesit e të përparimit.

Përderisa zemra ime dëshmon për mua se feja islame është e dobishme për të gjithë: për miqtë e mi, për fqinjët e mi, për ata që unë as nuk i njoh fare, për gratë e për burrat, për të moshuarit, për të pasurit e për të varfrit, për vendet e fuqishme e për ato të pafuqishme, për ata që dëshirojnë bashkimin e popujve, për ata që duan atdheun e tyre; përderisa ajo mundëson kontakt të gjallë midis meje dhe Zotit tim, atëherë unë besoj fuqimisht në vërtetësinë e saj dhe si mund ta lë këtë dhe të besoj në ndonjë gjë tjetër?


- Revista *"The Review of Religions"*, mars 1940, f. 26-31.



Namazi

ESENCA DHE FILOZOFIA E TIJ

Hazret Mirza Ghulam Ahmed ^{a.s.}



Përgjërimi në namaz

Një kriter shumë i rëndësishëm i dëlirësisë së besimtarit është namazi. Ai që përherë përgjërohet në namaz para Zotit, i jepet paqe. Si një fëmijë që qan me të madhe në prehrin e nënës dhe e ndien dashurinë dhe dhembshurinë e saj, në të njëjtën mënyrë, edhe ai që përgjërohet dhe dënes në namaz para Zotit, e dorëzon veten në prehrin e kujdestarisë dhe të dhembshurisë së Zotit. Mbani mend! Nuk e shijoi besimin ai që nuk gjeti dot kënaqësi në namaz.

Namazi nuk është thjesht ushtrim a lëvizje fizike. Disa e falin namazin duke rënë me kokë në sexhde dy-tri herë, siç çukit pula dhe e përfundojnë, e pastaj bëjnë lutje të gjata. Ndërkohë, koha që u ishte dhënë për të paraqitur kërkesa pranë Allahut, atë e kalojnë me nxitim, sikur kryejnë një zakon a traditë dhe luten pasi të largohen nga Zoti. Lutuni në namaz dhe namazin merreni si mjet për të bërë lutje.¹

Recitimi i El-Fatihës në namaz

Lutja është esenca dhe shpirti i namazit. Andaj, si mund ta gjesh këtë esencë jashtë namazit?! Një njeri që paraqitet në oborrin e mbretit dhe atij i jepet edhe mundësia për t'ia treguar problemin e vet, por ai atëherë nuk i thotë ndonjë gjë mbretit, por kur del jashtë nga oborri

mbretëror, fillon t'i lexojë kërkesat. Çfarë dobie ka kjo?! I njëjtë është shembulli i atyre që nuk luten me përgjërime e dënesë gjatë namazit. Andaj, çdo lutje që keni për të bërë, bëjeni në namaz dhe bëjeni duke përmbushur të gjitha kushtet e lutjes. Allahu i Madhërishëm që në krye të Kuranit na mësoi lutjen, gjithashtu edhe kushtet e lutjes. Është e obliguar ta themi suren El-Fatiha në namaz. Kjo lutje na tregon qartazi se lutjen në të vërtetë duhet ta bëjmë pikërisht në namaz.²

Namazin duhet ta falim në arabisht

Namazin nuk duhet ta falni në asnjë gjuhë tjetër, përveç asaj në të cilën u zbrit Kurani Famëlartë. Gjuhën e Kuranit nuk duhet ta braktisni. Po, pas lutjeve të caktuara gjatë namazit, kërkesat tuaja mund t'ia paraqitni Zotit të Madhërishëm në formë lutjesh. Por, gjuhën origjinale asnjëherë nuk duhet ta braktisni. Çfarë fituan të krishterët duke e braktisur gjuhën origjinale? Humbën çdo gjë.³

Çfarë është namazi? Ai është lutje që bën me përgjërime, duke e madhëruar Zotin, duke e lavdëruar, duke ia përmendur shenjtërinë, dhe duke i kërkuar falje (istigfar) dhe duke i dërguar salavate Profetit Muhammed (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të). Andaj, kur të falni namazin, si të pavëmendshëm mos u mjaftoni vetëm me fjalët arabe, sepse

namazi dhe istigfari i tyre të gjitha janë thjesht zakone, që nuk kanë asnjë lidhje me realitetin. Prandaj, kur ju të falni namazin, përveç pjesës së Kuranit sepse ajo është fjala e Zotit dhe përveç pjesës së lutjeve të Profetit, sepse ajo është fjala e Profetit, të gjitha lutjet e tjera bëjini me përgjërëm në gjuhën tuaj, në mënyrë që kjo përlësi e ky sinqeritet të ketë ndonjë ndikim në zemrat tuaja.⁴

Lutjet mund t'i bëni në gjuhën tuaj

Lutuni në namazet tuaja të pesë vakteve. Nuk është e ndaluar të bëni dua (lutje) në gjuhën tuaj. Nuk mund të keni kënaqësi në namaz, derisa nuk jeni të përqendruar dhe nuk mund të keni përqendrimin, derisa nuk tregoni përlësinë, dhe përlësinë mund ta keni atëherë kur të kuptoni atë që thoni. Andaj, shqetësimin dhe dëshirën do ta ndieni kur të paraqisni kërkesat në gjuhën tuaj. Por kjo në asnjë mënyrë nuk do të thotë se të gjithë namazin ta thoni në gjuhën tuaj. Jo. E kam fjalën që pas lutjeve dhe dhikrit të praktikuar, të luteni edhe në gjuhën tuaj.

Realisht, Zoti i ka bekuar fjalët që ka namazi. Namazi vetë është lutje. Andaj, lutuni në të që Zoti t'ju shpëtojë nga gjëmat e kësaj bote dhe të ahiretit dhe t'ju mundësojë fundin e mbarë. Lutuni edhe për gratë dhe fëmijët tuaj. Bëhuni të dëlirë dhe ruhuni nga çdo ligësi.⁵

Filozofia e namazeve të pesë vakteve

Çfarë janë namazet e pesë vakteve? Ato janë imazhi i gjendjeve tuaja të ndryshme. Jeta juaj në rast rreziku kalon përmes pesë ndryshimeve që janë të domosdoshme për natyrën tuaj.

Së pari, kur ju bëhet njoftimi që do të përballeni me një rrezik, për shembull, ju lëshohet urdhër arresti nga gjykata. Kjo është situata e parë që ju shqetësoi dhe jua mori rehatinë. Kësaj situatë i shëmbëllen koha e rënies së diellit, sepse ajo ka sjellë rënie në qetësinë tuaj. Është namazi i drekës që i përgjigjet kësaj situatë dhe që falet pasi të fillojë rënia e diellit nga zeniti.

Ndryshimi tjetër ju ndodh kur ju afrohet shumë rreziku. Për shembull, pas fletarrestimit, detyroheni të paraqiteni pranë gjykatësit, në këtë kohë kur ju thahet gjaku dhe ju zbehet fytyra, gati për t'u shuar. Kësaj situatë i përngjan koha kur diellit i zbehet drita për shkak të rënies, aq sa që të tjerët mund ta shohin me sy dhe binden se tashmë ai do të perëndojë. Kësaj situatë shpirtërore i përgjigjet namazi i ikindisë.

Ndryshimi i tretë ju ndodh atëherë kur humbni çdo shpresë për të shpëtuar nga gjëma që ju ka ardhur. Për shembull, kur shkruhet vendimi kundër jush se jeni fajtor, pasi dëshmitë janë kundër jush. Kjo është koha kur ju gati humbni ndjenjat, duke paraparë

veten në burg. Kësaj situatë i përngjan koha kur dielli sapo ka perënduar, duke marrë me vete gjithë dritën që ishte shpresë për vazhdimësinë e ditës. Kësaj situatë shpirtërore i përgjigjet namazi i akshamit.

Ndryshimi i katërt ju ndodh atëherë kur ju ndodheni në gjëmën që ju ka rënë, aq saqë veten e gjeni në terrnajën e saj. Për shembull, pasi të jetë lëshuar verdikti kundër jush dhe organi i drejtësisë ju dorëzon pranë policisë. Kjo situatë i përngjan kur nata bie me gjithë errësirën e saj dhe kësaj situatë i përgjigjet namazi i jacisë.

Më pas kur të kaloni një kohë të gjatë në këtë errësi, përfundimisht Zoti ju mëshiron, duke ju liruar nga errësira, ashtu siç agon sabahu pas natës. Po nga agimi i sabahut fillon të ndriçohet dita. Kësaj situatë shpirtërore i përgjigjet namazi i sabahut.

Kështu që, duke konstatuar pesë situata të ndryshme në gjendjen tuaj shpirtërore, Zoti i Madhërishëm ju ka lënë pesë namaze. Kjo tregon që namazet janë vetëm për dobinë tuaj. Andaj, nëse doni të shpëtoni nga këto gjëma, mos hiqni dorë nga namazet e pesë vakteve, sepse ato për ju janë si hije e ndryshimeve tuaja shpirtërore. Namazi ju sjell zgjidhje për gjëmën e ardhshme. Ju nuk e dini se çfarë fati do t'ju sjellë dita e re. Andaj, përpara se t'ju vijë dita e re, përgjërohuni

pranë Mikut tuaj, që juve t'ju vijë ditë e mbarë dhe e bekuar.⁶

Namazi ju mbron nga mëkatet

Edhe namazi është një mjet që ju mbron nga mëkatet. Është vetia e namazit që e largon njeriun nga mëkati dhe ligësia. Andaj, këtë namaz kërkojeni edhe ju dhe këtë namaz përpikuni ta falni. Namazi është shpirti i bekimeve. Përmes këtij namazi ju vijnë bekimet e Allahut të Madhërishëm. Andaj, zbukurojeni namazin tuaj, në mënyrë që të trashëgoni bekimet e Allahut të Madhërishëm.⁷

Rëndësia e pozicioneve të namazit

Çfarë është namazi? Namazi është të tregosh përlësinë, singëritetin dhe dobësitë e tua përpara Zotit dhe Atij t'i kërkossh përmbushjen e nevojave të tua. Namazi është herë të qëndrosh në këmbë duke i lidhur duart, për të pranuar madhështinë e Zotit dhe për t'i zbatuar urdhrat e Tij, dhe herë të biesh në sexhde me përlësi të skajshme, duke i kërkuar përmbushjen e nevojave të tua. Ky është namazi. Si një lypës që lëvdon herë pas here atë të cilit i lyp duke thënë: ti je i madh; ti je i mëshirshëm, shpreh madhështinë e Zotit dhe nxit mëshirën e Tij. Feja që nuk i ka këto gjëra, vetëm fe nuk mund të quhet...

Namazi është ta lidhësh zemrën vetëm me dashurinë ndaj Zotit, me druajtjen ndaj Tij dhe me kujtimin për Të, dhe

pikërisht kjo është feja. Pas kësaj, ai që dëshiron të lirohet fare nga namazi, çfarë ka bërë më shumë sesa shtazët?! Ushqehet njësoj si ato. Fle njësoj si ato. Kjo kurrresi nuk mund të jetë fe. Ky karakter është i mohuesve... Ai që dëshiron ta takojë Zotin e Madhërishëm, që dëshiron të arrijë te pragu i Tij, namazi për të është si një veturë, e cila shumë shpejt mund ta çojë atë në destinacion. Kurse ai që e braktisi namazin, si mund të arrijë te Zoti?!

Realisht, që kur muslimanët e braktisën namazin, ose hoqën dorë ta falnin atë me qetësinë, kënaqësinë dhe dashurinë e zemrës, duke neglizhuar thelbin e tij, Islami filloi të pësojë rënie. Studioni vetë se si ka qenë ajo periudhë e Islamit, kur muslimanët e gjallëronin namazin me përkushtim. Dikur Islami e kishte mundur gjithë botën. Që kur e braktisën namazin, edhe ata u bënë të braktisur. Pikërisht namazi që falet me dhimbjen e zemrës, e shpëton njeriun nga të gjitha vështirësitë. Vazhdimisht e kam provuar. Shpesh kur lutem gjatë një vështirësie, pa e mbaruar akoma namazin, Zoti ma lehtëson dhe ma zgjidh problemin.

Çfarë ndodh në namaz? Njëri parashtrohet kërkesën, i zgjat duart për të kërkuar ndihmë dhe Tjetri ia dëgjon çështjen deri në detaje. Pastaj, vjen një kohë kur Ai që dëgjonte, flet dhe i përgjigjet kërkuarit. Kështu ndodh me atë që fal namazin. Ai e ul kokën

në sexhde përpara Zotit dhe i tregon hallet dhe nevojat e veta. Pastaj, namazi i singertë dhe i vërtetë përfundimisht e sjell rezultatin dhe shpejt vjen koha që Zoti i Madhërishëm flet për t'iu përgjigjur dhe e qetëson me përgjigjen e Tij. Por kjo a mundet vallë, pa e provuar namazin e vërtetë?! Kurrresi jo.⁸

Namazi i vërtetë

Namazi i vërtetë është i atij që ka lidhje të vërtetë e të pastër me Allahun e Madhërishëm dhe ai kaq shumë të jetë i flijuar në pëlqimin dhe bindjen ndaj Allahut, sa që për t'i dhënë epërsi besimit mbi botën, të jetë i gatshëm edhe për të sakrifikuar jetën. Kur njeriu do ta ketë këtë gjendje, atëherë namazi i tij do të quhet namaz. Dhe derisa nuk krijohet ky realitet brenda njeriut, dhe derisa ai nuk tregon shembullin e singëritetit dhe të besnikërisë së vërtetë, namazi i tij dhe veprat e tij të tjera janë të paefektshme.⁹

Namazi, lutja dhe bindja

Mos falni namazin sikur çukitjet e pulës, por faleni me emocion dhe bëni shumë lutje. Namazi është çelësi për të zgjidhur çdo problem. Përveç lutjeve dhe fjalëve të praktikuara, lutuni shumë në gjuhën tuaj, në mënyrë që të arrini të përgjërohëni. Dhe derisa nuk ju vjen të përgjërohëni, mos u dorëzoni, sepse kjo metodë jua pastron nefsin dhe ju jepet gjithçka. Në të gjitha pozicionet që ka namazi, duhet që edhe zemra juaj

t'i ndjekë e t'i realizojë ato pozicione. Kur qëndroni në këmbë fizikisht, edhe zemra juaj duhet të qëndrojë përpara Zotit duke pranuar nënshtrimin ndaj Zotit. Kur përuleni fizikisht, edhe zemra juaj të përulet njësoj. Kur të bëni sexhde, edhe zemra juaj të bëjë sexhden. Sexhdeja e zemrës është që të mos shkëputeni nga Zoti në asnjë rrethanë. Kur të jetë kjo gjendja juaj, mëkatet do të fillojnë t'ju largohen.¹⁰

SHËNIME

1. "Melfuzat", vëll. 2, botimi 1984, f. 145.
2. "Melfuzat", vëll. 3, botimi 1984, f. 258.
3. "Melfuzat", vëll. 3, botimi 1984, f. 288.
4. "Kashti Nuh", "Ruhani Khezain", vëll. 19, f. 68-69.
5. "Melfuzat", vëll. 6, botimi 1984, f. 146.
6. "Kashti Nuh", "Ruhani Khezain", vëll. 19, f. 69-70.
7. "Melfuzat", vëll. 5, botimi 1984, f. 126.
8. "Melfuzat", vëll. 5, botimi 1984, f. 253-255.
9. "Melfuzat", vëll. 4, botimi 1984, f. 240.
10. "Melfuzat", vëll. 6, botimi 1984, f. 367-368.



MENDIMI JUAJ ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR NE

Na shkruani komentet, mendimet
dhe sugjerimet tuaja në

amj.albania@gmail.com

VËRTETËSIA

Mbulimi i gabimeve të të tjerëve

Nëse i binte në sy ndonjë dobësi e dikujt, Profeti ^{S.a.V.S.} ia mbulonte. E nëse dikush ia tregonte dobësinë e vet, edhe atë e ndalonte nga zbulimi i saj. Ai thoshte:

“Nëse robi i fsheh dobësinë robit tjetër, atëherë Allahu i Lartësuar atij do t’ia fshehë mëkatet në ditën e gjykimit”.¹

Profeti ^{S.a.V.S.} gjithashtu thoshte:

“Çdokujt nga umeti im, mund t’i shlyhen mëkatet (domethënë nga pendesa). Por nëse dikush vërtitet duke shfaqur mëkatet e tij, nuk ka dërmim për të”. Pastaj, duke treguar se çfarë do të thotë kjo, ai pohon: “Një njeri bën mëkat gjatë natës, të cilin Zoti ia mbulon. Por gjatë ditës, ai takon një shok të tij dhe i rrëfen – o filan, kështu kam bërë gjatë natës – më pas takon një shok tjetër dhe i thotë – o filan, kështu kam bërë gjatë natës. Natën Zoti ia mbuloi mëkatit, ditën ai e zhveshi veten”.²

Disa njerëz, nga padijenia mendojnë që rrëfimi i mëkatit sjell pendesën, kurse në të vërtetë, ai nuk e sjell pendesën, por shkakton paturpësi. Mëkati gjithsesi është një ligësi. Ata që bëjnë mëkat dhe në zemër ndiejnë turp e druajtje, dera e pendesës (teubesë) mbetet e hapur për ta dhe takvaja (druajtja ndaj Zotit) i ndjek ata. Gjatë jetës së tyre vjen ndonjë moment i bekuar kur takvaja i mbizotëron dhe mëkati u largohet. Por ata që përhapin mëkatet e tyre, madje edhe krenohen për to, atyre u hiqet përgjithësisht ndjenja e mëkatit dhe kur kalojnë në këtë fazë, atëherë ata nuk kanë më pengesë për mëkatit e tyre.

SHËNIME

1. “*Sahih Muslim*”, Kitab: “*El-Birr ves-sileh vel-Adab*”, Bab: “*Bishareti men seterall-llabu te’ala ‘alejhi fid-dunya bi-en jestura ‘alejhi fil-Abireti*”, hadithi nr. 6595.

2. “*Sahih el-Bubari*”, Kitab: “*El-edeb*”, Bab: “*Setril-mu’mini ‘ala nefsihi*”, hadithi nr. 6069.



Islami dhe

a është një përplas

Hazret Mirza Masrur Ahmed ^{a.b.a.}



ne Evropa
asje qytetërimesh?

Fjalimi i Hazret Mirza Masrur
Ahmedit (a.b.a.), Kalifi i Pestë
i Mesihut të Premtuar,
udhëheqës botëror
i Xhematit Musliman Ahmedia,
i mbajtur më 22 tetor 2019 në
hotel Adlon në Berlin, Gjermani.

Me emrin e Allahut, të
Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.

Të gjithë mysafirë të nderuar,

Es-selamu alejkum ve rahmetullahi
ve berekatuhu. Paqja dhe bekimet e
Allahut qofshin mbi ju të gjithë!

Para së gjithash, do të doja të shfrytëzoj
rastin për të falënderuar të gjithë
mysafirët që kanë pranuar ftesën tonë
dhe na janë bashkuar këtu në këtë
mbrëmje.

Në botën e sotme, veçanërisht në vendet
e zhvilluara perëndimore, ka një debat të
nxehhtë mbi emigracionin dhe mbi efektin
e tij në shoqëri. Debati më së shumti
është i përqendruar te muslimanët. Disa
qeveri dhe njerëz civilë kanë frikë nga
një “përplasje qytetërimesh” dhe besojnë
se muslimanët janë një kërcënim për
shoqërinë e tyre dhe se ata nuk mund
të integrohen në botën perëndimore.

Para se t’i përgjigjemi kësaj polemike,
është e rëndësishme të përcaktojmë se
çfarë kuptohet saktësisht me nocionin
“civilizim”. Në lidhje me këtë, paraqes
përkufizimin e dhënë nga Kalifi i Dytë
i Xhematit Musliman Ahmedia, me të
cilin jam plotësisht dakord.

Sipas mësimave të Islamit, ai e
përkufizoi civilizimin si progresin
material dhe zhvillimin e një shoqërie.
Faktorët që tregojnë forcën e një
civilizimi përfshijnë progresin e tij
ekonomik, nivelin e inovacionit në
teknologji, përparimin e mjeteve të
transportit dhe të komunikimit, si dhe
progresin intelektual të shoqërisë. Veç
kësaj, përpjekjet e një kombi për të
nxitur paqen dhe stabilitetin, qoftë në
sajë të zbatimit të ligjit të tij dhe të
aftësisë ushtarake, qoftë me ndonjë
metodë tjetër, gjithashtu është një masë
e civilizimit të tij.

E ndarë dhe e dallueshme nga civilizimi
është “kultura” e një kombi. Kultura
është një shfaqje e pikëpamjeve të
një populli, e qëndrimeve të tyre ndaj
çështjeve sociale dhe praktikave të tyre
dhe, në vend që të bazohet në përparimin
material, kultura është e rrënjësuar në
moralin dhe në vlerat fetare dhe traditat
e një kombi. Kështu që, civilizimi
është zhvillimi material, teknologjik
dhe intelektual i një shoqërie, ndërsa
kultura e saj bazohet në përbërjen fetare,
morale dhe filozofike të asaj. Dallimi

midis civilizimit dhe kulturës mund të kuptohet lehtësisht nëse kthehemi në periudhën e hershme të krishterimit.

Në atë kohë, Perandoria Romake ishte në kulmin e fuqisë së saj dhe, edhe tani, ajo konsiderohet si një nga qytetërimet më të mëdha në historinë e botës. Për shkak të prosperitetit të tyre material, të urbanizimit dhe të mënyrës së qeverisjes së territoreve të saj, romakët konsideroheshin jashtëzakonisht shumë të civilizuar e të arsimuar. Megjithatë, sofistikimi i tyre nuk shoqërohej nga standardet e larta të moralit. Përkundrazi, ishte krishterimi i periudhës së parë ai që frymëzoi te njerëzit e asaj shoqërie një kulturë përparimtare.

Krishterimi u dha njerëzve parime udhëzuese të bazuara në fe dhe moral, ndërsa romakët përcaktuan ligjet dhe kufijtë e botës tokësore. Kështu që, përparimi material dhe zhvillimi i romakëve pasqyronte civilizimin e tyre madhështor, ndërsa Krishterimi i dha popullit një kulturë të lavdishme. Me kalimin e kohës, Krishterimi u bë feja mbizotëruese e Perandorisë Romake dhe kështu kultura që ajo vendosi u përvetësua nga një civilizim i madh. Të dyja bashkë me ndikimin e tyre suprem, vendosën themelet për vlerat dhe traditat që mbesin edhe sot në Perëndim.

Ndërsa njerëzit në Perëndim po largohen nga feja, vlerat themelore morale që janë



të ngulitura në shoqërinë perëndimore janë ato të dhëna nga Krishterimi. Sa i përket debatit për emigracionin, në dekadat e fundit, demografia e disa vendeve perëndimore ka ndryshuar. Emigrantët kanë mbërritur nga shumë vende, por ka qenë fluksi i muslimanëve që ka shkaktuar shqetësimin dhe alarmin më të madh. Shumë njerëz vendas kanë frikë se emigrimi masiv nga vendet muslimane kërcënon civilizimin, kulturën dhe vlerat e tyre, të cilat ekzistojnë prej shumë shekujsh.

Siç e kam sqaruar, ne e konsiderojmë civilizimin si zhvillimin material dhe avancimin e shoqërisë dhe vendet në zhvillim kërkojnë ta imitojnë rritjen dhe zhvillimin e Perëndimit dhe jo që ta refuzojnë, ta kundërshtojnë a ta mohojnë atë. Si rrjedhojë, jo që civilizimi perëndimor po braktiset, përkundrazi shohim të kundërtën. Për shkak të mjeteve moderne të transportit dhe të komunikimit, bota është bërë një fshat global. Vendet e tjera po ndikohen nga civilizimi perëndimor dhe aspirojnë për të arritur nivele të tilla të përparimit material dhe të inovacionit.

Andaj, pohimi se civilizimi perëndimor ose evropian është i kërcënuar nga prania e muslimanëve, nuk qëndron. Përkundrazi, civilizimi perëndimor po ndikon në pjesë të tjera të botës, duke përfshirë edhe botën muslimane. Nga ana tjetër, një frikë se kultura fetare dhe

morale e Perëndimit mund të kërcënohet nëse Islami përhapet në Evropë është një shqetësim më i arsyeshëm dhe unë tani do të trajtoj këtë pikë.

Së pari, është e pamohueshme që njerëzit po largohen me shpejtësi nga feja dhe kjo prirje është veçanërisht e theksuar në Perëndim. Në vendet perëndimore, sa herë që bëhet regjistrimi i popullsisë, rezulton se njerëzit janë gjithnjë e më pak të prirur drejt fesë a besimit në Zot. Nisur nga kjo, unë besoj se përhapja e shpejtë e ateizmit është një kërcënim shumë më i madh për kulturën perëndimore sesa Islami. Vlerat e Perëndimit janë shumëshekullore dhe bazohen në traditat e tij fetare dhe veçanërisht në trashëgiminë e tij të krishterë dhe hebreje. Pra, këto vlera fetare dhe norma kulturore janë nën sulm nga ata që kundërshtojnë të gjitha format e fesë dhe të besimit.

Kështu që, si një udhëheqës fetar musliman, besoj se ju duhet të mbronit trashëgiminë dhe kulturën tuaj duke fokusuar energjitë tuaja në ndaljen e rënies së fesë dhe në kthimin e njerëzve përsëri drejt fesë dhe besimit - qoftë ky krishterimi, judaizmi apo ndonjë tjetër. Nuk duhet që, në emër të "progresit", vlerat dhe standardet morale që kanë qenë pjesë e shoqërisë për shumë shekuj, papritmas të braktisen. Unë gjithashtu besoj se rënia e fesë në Perëndim është arsyeja kryesore që njerëzit i frikësohen

Islamit, sepse ata e dinë se muslimanët, përgjithësisht, qëndrojnë të lidhur me besimin e tyre.

Në dritën e kësaj, dëshiroj të sqaroj se, pavarësisht nga ajo që dëgjoni ose lexoni në media, nuk ka asnjë arsye të frikësoheni nga Islami. Muslimanët besojnë se Kurani i Shenjtë është një mësim i përsosur dhe përfundimtar i fesë dhe pikërisht për shkak të dashurisë dhe bindjes sonë ndaj Kuranit të Shenjtë, ne besojmë me vendosmëri se feja është çështje e zemrës dhe personale për çdo individ. Në ajetin [vargun] 257 të sures [kapitullit] 2, Kurani Famëllartë ka thënë kategorikisht se nuk duhet të ketë imponim në çështjet e fesë.

Prandaj, nuk ka nevojë që jomuslimanët të kenë frikë se muslimanët do të përpiqen të përhapin me forcë bindjet e tyre ose të imponojnë pikëpamjet e tyre në këtë pjesë të botës. Ideologjia urrejtëse e pakicës së vogël të të ashtuquajturve muslimanë që kanë adoptuar ekstremizmin, nuk ka asnjë lidhje me mësimet e Kuranit Famëllartë.

Në të vërtetë, kam thënë shumë herë që qeveritë dhe autoritetet përkatëse duhet të trajtojnë rreptësisht me ekstremistët, qofshin ata muslimanë apo jomuslimanë. Për sa i përket Xhematit Musliman Ahmedia, ne besojmë se Islami në asnjë rrethanë nuk lejon përdorimin e forcës ose ndonjë lloj shtrëngimi në përhapjen e fesë. Pse atëherë dikush të frikësohet nga Islami? Pse disa njerëz mendojnë se civilizimi apo kultura e tyre është në rrezik nga muslimanët? Tani, pasi shpjegova ndryshimet mes civilizimit dhe kulturës nga një këndvështrim islam, do të doja të paraqisja disa nga mësimet thelbësore të Islamit.

Shumë mite dhe ide të gabuara për Islamin dhe Themeluesin e tij (paqja dhe bekimet qofshin mbi të) janë përhapur, dhe ngaqë nuk është e mundur të mbuloj të gjitha aspektet e mësimave islame në një kohë kaq të shkurtër që kam në dispozicion, do të doja të përmend disa nga të drejtat e njeriut që Islami ka vendosur. Një ajet shumë domethënës i Kuranit të Shenjtë, përsa u përket të



drejtave të njeriut, është ajeti 37 i sures 4, i cili thotë:

“Adhurojeni Allahun dhe mos barazoni asgjë me Të. Dhe bëjuni mirësi prindërve, të afërmve, jetimëve, të varfërve, fqinjëve farefis dhe fqinjëve jofarefis, shokëve, udhëtarëve dhe atyre që janë në pronësinë tuaj.”

Në këtë ajet, Allahu i Madhërishtëm porositi muslimanët që ta adhurojnë Atë. Ai gjithashtu i porositi që të trajtojnë prindërit me dashuri e dhembshuri. Si mundet që ky mësim që u kërkon muslimanëve të duan dhe nderojnë prindërit e tyre, të ketë përplasje me ndonjë fe apo komb?

Ajeti gjithashtu kërkon që muslimanët t'i trajtojnë të afërmit dhe të dashurit e tyre me mirësi dhe konsideratë. Ai kërkon që ata të mbështesin dhe të përkrahin anëtarët më të rrezikuar dhe nën-privilegjuar të shoqërisë, siç janë jetimët. Në këtë drejtim, ne besojmë se

një nga mënyrat kryesore për të ndihmuar të varfërit është përmes edukimit. Nëse mosha të reja të shoqërisë, që vijnë nga shtëpitë e prishura ose që janë të goditura nga varfëria, do të arsimohen, kjo do t'i lejojë ata të çlirohen nga prangat e varfërisë. Atyre do t'u hapen mundësi dhe kështu, duke qenë larg zhgënjimit dhe pakënaqësisë, të rinjtë e tillë do të rriten për t'u bërë pjesëtarë produktivë të shoqërisë, në vend se të joshen drejt një jete të krimit dhe të bandave.

Kjo është arsyeja pse Xhemati Musliman Ahmedia i jep rëndësi të madhe arsimit, dhe brenda mundësive tona të kufizuara, kemi ndërtuar shkollë në vende të ndryshme afrikane dhe financojmë bursa për studentë që nuk mund të përballojnë arsim të lartë. Ne gjithashtu besojmë se vendet e pasura duhet të ndihmojnë kombet më të dobëta të botës, që ato të ndërtojnë themele të forta. Nëse vendet e varfëra arrijnë të ndërtojnë ekonominë dhe infrastrukturën e tyre, njerëzit e tyre



do të kenë mundësi pranë shtëpisë së tyre dhe do kenë shumë më pak arsye për të migruar jashtë vendit. Nëse kombet e tyre janë të qëndrueshme dhe të prosperuara, rrjedhimisht do të përfitojnë edhe rajoni, edhe bota më e gjerë.

Në ajetin e lartpërmendur të Kuranit të Shenjtë, përmendet posaçërisht për të përmbushur të drejtat e fqinjëve, qoftë ata muslimanë apo jomuslimanë, gjë që përcakton se shtrirja e fqinjëve është jashtëzakonisht e gjerë. Veç kësaj, Profeti i Islamit (paqja dhe bekimet qofshin mbi të) tha që Zoti i Madhërishëm i kishte theksuar të drejtat e fqinjëve aq fort, saqë ai mendoi se fqinjët do të përfaqësoheshin mes trashëgimtarëve të ligjshëm të njeriut.

Themeluesi i Islamit (paqja dhe bekimi qoftë mbi të) gjithashtu na mësoi se ai që nuk është mirënjohës ndaj njerëzve, nuk mund të jetë mirënjohës ndaj Allahut të Madhërishëm.

Sa parim i bukur!

Pra, është e nevojshme që krahas adhurimit ndaj Zotit, muslimani duhet të përmbushë të drejtat ndaj njerëzimit. Përsëri, do të pyesja si mund të jetë ky mësim një kërcënim për civilizimin perëndimor? Prandaj, sipas mendimit tim, është kundër-produktive për njerëzit perëndimorë të sugjerojnë se Islami ose muslimanët nuk kanë vend

në këtë pjesë të botës.

Nëse muslimanët vijnë këtu që të integrohen, që të përmbushin të drejtat fqinjësore dhe të përpiqen për paqen dhe përmirësimin e shoqërisë, atëherë me siguri kjo është diçka për të lavdëruar, sesa për të dënuar apo për të sharë. Duke vazhduar më tej, disa njerëz argumentojnë ose besojnë se muslimanët janë porositur të kryejnë “xhihad” dhe kështu ata kanë frikë se muslimanët do të vijnë në Perëndim dhe “do të bëjnë një luftë të përgjakshme”, duke kërkuar të zbatojnë një civilizim dhe kulturë islamike dhe të shkatërrojnë paqen e shoqërisë. Kjo bazohet në një keqkuptim të qartë të asaj ç’ka është xhihadi dhe pse u bënë luftërat fetare në periudhën e parë të Islamit. Islami nuk është një fe e dhunshme e gjakatare.

Njëherë një sahab [shok] i Profetit Muhammed (paqja dhe bekimet qofshin mbi të) kërkoi të bashkohej me ushtrinë muslimane në mënyrë që të merrte pjesë në xhihad. Profeti i Islamit (paqja dhe bekimet qofshin mbi të) e refuzoi kërkesën e tij dhe tha se ngaqë prindërit e tij ishin në gjendje të dobët, ai duhej të qëndronte në shtëpi dhe të kujdesej për ta dhe kjo konsiderohej si xhihad i tij. Nëse qëllimi i xhihadtë ishin pushtimi, gjakderdhja dhe lufta, Profeti i Islamit (paqja dhe bekimet qofshin mbi të) me siguri do ta pranonte ofertën e tij për të forcuar ushtrinë muslimane.

Më duhet të sqaroj se është e vërtetë që ushtritë muslimane luftuan në disa luftëra fetare gjatë periudhës së hershme të Islamit, por qëllimi kurrsesi nuk ishte të mposhtin, të shtypnin ose të detyrojnë njerëzit për të pranuar Islamin. Këto luftëra u bënë për të mbrojtur vetë institucionin e fesë dhe për të mbështetur parimin e lirisë së besimit. Në ajetet 40-41 të sures 22, Kurani Famëllartë pohon qartazi se nëse agresorët nuk do të ndaloheshin, kishat, sinagogat, tempujt, xhamitë, të gjitha vendet e adhurimit do të kërcënoheshin rëndë, pasi qëllimi kryesor i mohuesve të Mekës ishte për të shkatërruar të gjitha gjurmët e fesë nga faqja e dheut.

Për sa i përket rritjes së fëmijëve, ajeti 152 i sures 6 të Kuranit të Shenjtë thotë

se muslimanët nuk duhet të “mbysin fëmijët e tyre”. Kjo urdhëresë i porosit muslimanët të ushqejnë fëmijët e tyre me dashuri e dhembshuri, t’i udhëzojnë moralisht dhe t’i edukojnë në atë mënyrë që ata të bëhen individë me aftësi dhe morale të larta, duke u bërë kështu asetë të rëndësishëm për shoqërinë dhe kombin e tyre.

Po kështu, Islami ka mësuar muslimanët të mbrojnë të drejtat e anëtarëve të dobët të shoqërisë. Për shembull, sipas ajetit 7 të sures 4 të Kuranit, muslimanët janë të detyruar të mbrojnë fëmijët jetimë nga shfrytëzimi dhe të mbrojnë trashëgiminë e tyre në tërësi, derisa ata të arrijnë në një moshë, kur mund ta menaxhojnë vetë atë.



Një tjetër akuzë e rëndomtë që dëgjojmë në botën perëndimore është se muslimanët nuk respektojnë gratë ose të drejtat e tyre.

Para së gjithash, duhet theksuar se Islami ishte feja e parë që u dha grave të drejtën e trashëgimisë, të drejtën e divorcit, si dhe shumë të drejta të tjera. Për më tepër, Islami thekson rëndësinë e madhe për arsimimin e vajzave dhe për t'u siguruar mundësi të rritjes dhe të zhvillimit personal. Gjithashtu, në një thënie të famshme të tij, Profeti i Shenjtë i Islamit (paqja dhe bekimi qoftë mbi të) tha: "Parajsa gjendet nën këmbët e nënës". Këto fjalë ilustrojnë rolin e rëndësishëm që gratë luajnë në shoqëri, si dhe statusin e tyre unik e të veçantë në shoqëri. "Nënat" janë njerëzit

që kanë fuqinë dhe ndikimin për t'i kthyer kombet e tyre në një "parajsë në tokë" dhe që mund të hapin dyert e një Parajse të përjetshme për fëmijët e tyre. Sërish, në ajetin 20 të sures 4, Kurani i Shenjtë ka thënë se burrat muslimanë duhet t'i trajtojnë gratë e tyre me dashuri dhe respekt.

Në vendet perëndimore, nuk ka ditë pa pasur raportime të policisë ose të gjykatave që detyrohen të ndërhyjnë dhe të merren me raste të tmerrshme të abuzimit në familje. Studime dhe raporte të ndryshme, siç është raporti i vitit 2018 nga Zyra e Statistikave Kombëtare në Mbretërinë e Bashkuar, vërtetojnë se krime të tilla nuk kanë lidhje me asnjë fe, dhe një raport tjetër i fundit ka treguar që e njëjta gjë është edhe këtu në Gjermani. Prandaj, është tërësisht e padrejtë ta quajmë Islamin si fe që paragjykon shumë gratë.

Islami gjithashtu u kërkon ndjekësve të vet të respektojnë ndjenjat e fesë dhe të besimit të njerëzve të tjerë. Besëlidhja e Medinës ishte një ilustrim real i këtij mësimi, ku Tevrati u njoh dhe u respektua si Libri që mbante ligjin e Judenjve. Madje, Islami ka vendosur të drejtat edhe të armiqve dhe kundërshtarëve. Kështu, ajeti 191 i sures 2 të Kuranit të Shenjtë thotë se asnjë padrejtësi a shkelje nuk duhet të bëhet kundër armikut qoftë në gjendje lufte.



Fatkeqësisht, në botën e sotme, e cila krenohet se është më e civilizuar dhe më e zhvilluar se çdo epokë e mëparshme, individë dhe shtete shpesh nuk pranojnë të drejtat e kundërshtarëve të tyre, kryejnë mizori të mëdha dhe nuk humbin asnjë mundësi për hakmarrje. Në ajetin 9 të sures 5 të Kuranit të Shenjtë, Allahu i Madhërishëm ka shpallur se armiqësia ndaj një kombi a populli, kurrsesi nuk duhet të nxisë dikë të sakrifikojë parimet e drejtësisë dhe të barazisë. Përkundrazi, Islami mëson se në të gjitha rrethanat, pavarësisht sa sfiduese janë, duhet t'u përmbaheni plotësisht parimeve të drejtësisë dhe të integritetit dhe kurrë nuk duhet të motivoheni nga një dëshirë hakmarrëse. Si rezultat i këtij mësimi të shkëlqyeshëm, shohim shembullin e pashoq të faljes, dhembshurisë dhe mëshirës që ka treguar Profeti i Shenjtë Muhammed (paqja dhe bekimet qofshin mbi të) në kohën e çlirimit të Mekës.

Historia vërteton se muslimanët u vranë, u plaçkitën dhe u torturuan në Mekë dhe në fund, u dëbuan nga vatrat e tyre dhe iu desh të migronin. Megjithatë, kur Profeti u kthye me fitore në Mekë dhe i gjithë qyteti ishte nën komandën e tij, deklarata e tij e parë ishte se nuk do të merrte hak aspak nga ata, të cilët i kishin persekutuar brutalisht muslimanët. Ai deklaroi se, në përputhje me mësimet

e Islamit, të gjithë ata që kishin torturuar muslimanët, do të falëshin menjëherë dhe se askush nuk do të trajtohej padrejtësisht, pavarësisht se e pranonin apo jo Islamin.

Një tjetër revolucion moral në favor të anëtarëve më të dobët të shoqërisë që ka sjellë Islami lidhet me skllavërinë, e cila para Islamit ishte e shfrenuar dhe konsiderohej si pjesë normale e shoqërisë. Në ajetin 34 të sures 24, Kurani i Shenjtë thotë se nëse një skllav kërkon liri, ai duhet të lirohet dhe, nëse caktohen taksa fiskale për lirim të tij, ato duhet të jenë të arsyeshme dhe të pagueshme në këste të vogla lehtësisht të menaxhueshme, ose të hiqen krejt.

Në botën e sotme, skllavëria fizike nuk ekziston më, por ajo është zëvendësuar me varësinë dhe skllavërinë ekonomike, ku marrëdhënia midis kombeve më të fuqishme të planetit dhe vendeve më të dobëta është bërë e ngjashme me marrëdhëniet e një padroni dhe një skllavi. Për shembull, "huatë" e maskuara si "paketa ndihmëse" jepen nga vendet e pasura për vendet e dobëta dhe këto të fundit nuk kanë mundësi tjetër përveçse të pranojnë me të gjitha kushtet e bashkangjitura. Në çdo rast, nivelet e larta sakatuese të interesit synojnë që kreditë afatshkurtra t'i shtypnë

vendet në mjerim dhe varësi afatgjatë. Rezultati përfundimtar është se vendi debitor që nuk ka mundësi ta shlyejë borxhin nuk ka mundësi tjetër përveçse t'i nënshtrohet vullnetit të kombit mbizotërues. Një skllavëri e tillë është me të vërtetë imorale.

Që në fillim, Islami gjithashtu vendosi të drejtat e jomuslimanëve dhe i këshilloi muslimanët të tregohen të përmbajtur për hir të paqes dhe të unitetit të shoqërisë. Për shembull, në ajetin 109 të sures 6, Kurani i Shenjtë deklaroi se muslimanët nuk duhet të flasin keq as për idhujt e idhujtarëve, sepse kjo mund t'i provokojë ata të flasin kundër Allahut të Madhërishëm.

Në kohën e shkurtër që kisha në dispozicion, unë përmenda vetëm disa pika që ilustronin të drejtat e njeriut që janë vendosur nga Islami. Shpresoj që ato që kam thënë do t'ju sigurojnë që Islami nuk është kërcënim për civilizimin perëndimor ose për kulturën e tij. Nëse ka muslimanë që uzurpojnë të drejtat e jomuslimanëve, kjo ndodh vetëm sepse "muslimanët" e tillë refuzojnë mësimet e Islamit ose janë plotësisht injorantë ndaj tyre. Si përfundim, është e qartë që ne po jetojmë në një botë të tendosur dhe druaj se situata e pasigurt me të cilën po përballemi, mund të përshkallëzohet në çdo kohë.

Njerëzit duhet të kuptojnë se fjalët

mund të sjellin pasoja shumë të rënda dhe kështu, në vend që të flasin për një "përplasje civilizimesh" ose të shkaktojnë pa pasur nevojë tensione mes komuniteteve të ndryshme, duhet të frenojnë veten nga sulmet kundër mësimave fetare të njëri-tjetrit. Në vend që të kërkojmë të vendosim kufizime mbi lirinë dhe shprehjen e besimit, duhet të pranojmë që të gjithë jemi pjesë e një race njerëzore, më të lidhur se kurrë më parë. Duhet të përqafojmë diversitetin tonë dhe të përqendrohemi në krijimin e unitetit, në mënyrë që paqja afatgjatë të mund të rrënojset në botë. Sidoqoftë, aktualisht po shohim të kundërtën. Vendet muslimane dhe jomuslimane njësoj i vendosin interesat e veta përpara interesave të botës së gjerë dhe po kalojnë çdo kufi të drejtësisë dhe të moralit në ndjekjen e qëllimeve të tyre.

Reminishenca e ditëve të errëta të së kaluarës, blloqet opozitare dhe alencat po formohen dhe duket sikur bota është e prirur për të thirrur shkatërrimin e vet. Sot, ka një mori vendesh që zotërojnë bomba bërthamore ose armë të tjera shkatërruese, të cilat kanë potencialin për të shkatërruar civilizimin, siç e dimë ne. Kush do të thotë se këto armë nuk do të përdoren kurrë ose nuk do të përfundojnë në duar të gabuara? Nëse armët bërthamore do të përdoren ndonjëherë, nuk do të jemi vetëm ne që do të mbajmë pasojat, madje fëmijët

tanë dhe gjeneratat e ardhshme do të detyrohen të vuajnë për mëkatet tona. Gjeneratat e fëmijëve do të lindin me aftësi të kufizuara intelektuale dhe fizike dhe shpresat dhe ëndrrat e tyre do të shkatërrohen pa asnjë faj të tyre. A është kjo trashëgimia e ndarjes që do të donim t'ua lëmë pasaardhësve tanë? Me siguri jo!

Kështu, në vend që të ndezim flakët e urrejtjes, qoftë bazuar në dallime fetare ose etnike ose për qëllime politike, ne

duhet të njohim shenjat paralajmëruese dhe të ndryshojmë mënyrat tona, para se të jetë shumë vonë. Të gjithë ne, pavarësisht nga dallimet tona, le të bashkohemi dhe të punojmë me një frymë respekti të ndërsjellë, me një frymë tolerance dhe dashurie për paqen e botës e të promovojmë lirinë e besimit.

Me këto fjalë, do të doja t'ju falënderoja edhe një herë që u bashkuat me ne këtë mbrëmje.

Faleminderit shumë!



Durimi

Profeti ^{s.a.v.s.} thoshte:

“Besimtari ka vetëm të mira në këtë botë dhe përveç tij, askush tjetër nuk gëzon këtë fat.

Kur gëzon ndonjë sukses, ai falënderon Zotin për të dhe kështu atë e pret shpërblimi nga Zoti i Lartësuar. E nëse e godet ndonjë vështirësi, ai duron dhe edhe kështu atë e pret shpërblimi nga Zoti i Lartësuar”.¹ “Nëse robi i fsheh dobësinë robit tjetër, atëherë Allahu i Lartësuar atij do t’ia fshehë mëkatet në ditën e gjykimit”.¹

Afër vdekjes së tij, Profeti ^{s.a.v.s.}, një ditë, po rënkonte nga dhimbjet e sëmundjes. E bija Fatimja r.a. u shpreh e shqetësuar: “Ah, nuk i shoh dot dhimbjet e babait tim”. Profeti ^{s.a.v.s.}, kur e dëgjoi, i tha:

“Duro moj bijë! Pas kësaj dite, asnjë dhimbje nuk do ta kapë babanë tënd”.²

Domethënë, ai i thoshte që dhimbjet e tij do të ishin vetëm në këtë botë dhe atë ditë ai do të shkonte te Zoti i tij, për të mos pasur më kurrë ndonjë dhimbje.

Në vazhdë të kësaj teme, le të përmendim edhe një porosi tjetër të Profetit ^{s.a.v.s.}. Nëse binte ndonjë epidemi, Profeti ^{s.a.v.s.} kurrë nuk dëshironte që dikush të largohej nga vendi i tij, sepse në këtë mënyrë, kishte rrezik që sëmundja të përhapej edhe në vende të tjera. Ai thoshte që nëse ndokush preket nga ndonjë epidemi dhe ai duron e qëndron në vendin e tij për të mos e përhapur sëmundjen në vende të tjera dhe vdes nga ajo, atëherë ai do të vlerësohet si dëshmor.³

SHËNIME

1. “*Sahib Muslim*”, Kitab: “*Ez-zuhd ver-Rikaik*” Bab: *El-mu'minu emrubu kul-luhu khajrun*”, hadithi nr. 7500.
2. “*Sahib el-Buhari*”, Kitab: “*El-megazi*”, Bab: “*Meredin-Nebiji sal-lall-llahu 'alejhi ve sel-leme ve vefatibi*”, hadithi nr. 4428.
3. “*Sahib el-Buhari*”, Kitab: “*Et-tib*”, Bab: “*Exbris-sabiri fit-ta'un*”, Hadithi nr. 5734.

(Marrë nga “*Jeta e Muhammedit s.a.*”, Tiranë, 2013, f. 327-328)



Etika dhe rëndësia e leximit të Kuranit

Hazret Mirza Masrur Ahmed ^{a.b.a.}

Ky material është një përmbledhje nga hutbja e Hazret Kalifit të Pestë të Xhematit Musliman Abmedia (Allahu e ndihmoftë fuqimisht), i mbajtur më 21.10.2005.

Kurani Famëlartë, siç e dimë, ka një lidhje të veçantë me muajin Ramazan. Kurani filloi të zbritej pikërisht në këtë muaj. Zoti i Madhërishëm i dëgjoi përgjërimet dhe lutjet Profetit Muhammed ^{s.a.v.s.}, dhe hapi portat e mëshirës së Tij, duke e caktuar si udhëzues për tërë njerëzimin

Profetin ^{s.a.v.s.}, njeriun që mbetej tejte i shqetësuar nga papastërtia dhe idhujtaria ku ishte e zhytur bota, dhe duke i dhënë Librin e Tij përfundimtar. Ky Sheriat vijoi të zbritej për 23 vite të ardhshme.

Çdo Ramazan Xhibraili ^{a.s.} bënte leximin e Kuranit përpara Profetit ^{s.a.v.s.}



Në çdo Ramazan, Xhibraili vinte te Profeti^{s.a.v.s.} dhe lexonte Kuranin e zbritur deri atëherë. Dhe në Ramazanin e fundit të jetës së tij, pra, në vitin kur ishte kompletuar Kurani së zbrituri, Xhibraili^{a.s.} bëri dy herë leximin e Kuranit të Shenjtë përpara Profetit Muhammed^{s.a.v.s.}.

Ky është suneti i Profetit^{s.a.v.s.}, të cilin

besimtari duhet ta vijojë. Sidomos gjatë Ramazanit, të paktën një herë ose dy herë, duhet të kryejë leximin e Kuranit nga fillimi deri në fund. Ata që gjejnë mundësi, e lexojnë edhe më shumë, por nuk duhet nxituar gjatë leximit të Kuranit. Leximi i Kuranit duhet bërë duke kuptuar fjalët dhe domethëniet e tij.

Në sa kohë duhet ta përfundosh leximin e Kuranit?

Për sahabët e Profetit ^{s.a.v.s.} Kurani i Shenjtë ishte në gjuhën mëmë të tyre. Edhe atyre Profeti ^{s.a.v.s.} u tha:

“Ai që përfundoi leximin e Kuranit në më pak se tri ditë, nuk ka kuptuar asgjë nga Kurani”.¹

Kurse në një rrëfim tjetër përmendet edhe për shtatë ditë. Pra, Profeti ^{s.a.v.s.} u jepte porositë sahabëve në bazë të kapacitetit të tyre. Dhe qëllimi edhe në porosinë në fjalë është që të lexoni Kuranin, të thelloheni në kuptimet, që më pas t'i bëni ato pjesë të jetës. Nëse nuk lexoni Kuranin në këtë mënyrë, nuk ka ndonjë dobi.

Sahabët e Profetit ^{s.a.v.s.} e kuptuan shumë mirë këtë pikë për sa i përket leximit të Kuranit. Për këtë arsye, Vetë Zoti i Madhërishëm ka dëshmuar për ta në Kuranin Famëlartë që ata e kryenin në mënyrë të denjë obligimin e leximit të këtij Libri të Shenjtë. Siç e thotë:

الَّذِينَ آتَيْنَاهُمُ الْكِتَابَ يَتْلُونَهُ حَقَّ تِلَاوَتِهِ أُولَٰئِكَ يُؤْمِنُونَ بِهِ ۖ وَمَنْ يَكْفُرْ بِهِ
فَأُولَٰئِكَ هُمُ الْغَافِرُونَ ﴿﴾

“Ata që u kemi dhënë Librin, që e lexojnë ashtu siç duhet lexuar ai, me të vërtetë besojnë në të. Kurse ata që e mohojnë atë, gjithsesi janë të humbur”.²

Pra, këta ishin ata, të cilët Profeti Muhammed ^{s.a.v.s.} i shndërroi përmes

këtij Libri dhe përmes fuqisë bekuese të tij, në njerëz, pastaj në adhurues të Zotit e më pas në njohës të Zotit. Vallë, çfarë detyre kishin kryer ata për sa i përket leximit të Kuranit? A mjaftoheshin vallë, vetëm me leximin sipërfaqësor të tij? Jo.

Koha dhe mënyra për të lexuar Kuranin

Duke treguar rëndësinë e leximit të Kuranit në kohën e sabahut, Zoti i Madhërishëm tha:

وَقُرْآنَ الْفَجْرِ ۖ

“Përmbaju leximit të Kuranit në sabah.”

Dhe më pas thotë:

إِنَّ قُرْآنَ الْفَجْرِ كَانَ مَشْهُودًا

“Vërtet, leximi i Kuranit në sabah (është një vepër që) dëshmohet”.³

Prandaj, besimtarët duhet ta lexojnë Kuranin sidomos gjatë sabahut. Por sërish, e rëndësishme është që ta lexojnë duke e kuptuar. Për këtë arsye, Profeti Muhammed ^{s.a.v.s.} porosi të sahabiun e tij ‘Abdullah ibni ‘Amrin ^{r.a.}, duke thënë:

“Lexo Kuranin e Shenjtë nga fillimi deri në fund gjatë një muaji”.⁴

Një tjetër porosi e Kuranit pikërisht për leximin e tij është ai ku Zoti thotë:

وَرَتِّلِ الْقُرْآنَ تَرْتِيلًا

“Lexoje Kuranin duke e zbukuruar atë”.⁵

Hazret Kalifi i Pestë i Xhematit Musliman Ahmedia thotë:

“Unë isha në një udhëtim me një person dhe po bënim dedikim të përkohshëm. Një ditë pas namazit të sabahut përfundova leximin e Kuranit. Ai më tha:

– Nuk shpresoja kështu prej teje!

U shqetësova se çfarë gabimi mund të kem bërë. – Çfarë ndodhi?, e pyeta.

– Shoh prej dy-tri ditësh që ti kur lexon Kuranin, e lexon shumë ngadalë, gjë që do të thotë se nuk ditke ta lexosh rrjedhshëm dhe ngecke gjatë leximit, m'u përgjigji ai.

I thashë: – Jo, unë nuk ngec gjatë leximit, por kështu e kam shprehinë për leximit e Kuranit. E lexoj ngadalë-ngadalë Kuranin e Shenjtë.

Unë atëherë nuk e dija referencën e këtij hadithi e as nuk më erdhi në mendje ajeti i Kuranit Famëlartë që e citova më lart. Megjithatë, i thashë se unë di ta lexoj edhe shpejt, madje le të bëjmë garë për leximin e shpejtë, por unë e lexoj Kuranin siç më pëlqen mua.

Pra, e kam fjalën që disa njerëz për të treguar dijen e tyre, insistojnë të lexosh shpejt, kurse Allahu dhe i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} po thonë se duhet ta lexosh duke kuptuar dhe kjo pikërisht është më e mira. Përveç kësaj, çdo njeri ka aftësi

të ndryshme të të perceptuarit të gjërave. Prandaj, secili ta lexojë Kuranin duke e kuptuar atë, sipas ritmit që mund ta ndjekë ai. Edhe nëse e dini përkthimin e Kuranit, prapëseprapë, duhet ta lexoni ngadalshëm aq saqë të jeni duke kuptuar domethënien e tij”.

Rëndësia për ta kuptuar Kuranin gjatë leximit të tij

Hazret Mesihu i Premtuar ^{a.s.} thotë:

“Lexoni Kuranin Famëlartë me vëmendje dhe thellohuni në të. Në këtë libër është gjithçka. Aty janë shpjeguar mirësitë dhe ligësitë, janë parashikime për të ardhmen etj.. Kuptojeni mirë se Kurani paraqet një fe, e cila nuk mund të kundërshtohet, sepse jep frutat bekimet e saj në çdo kohë.

Ungjilli nuk e paraqet fenë në mënyrë të përsosur. Mësimi i tij mund të ketë qenë i përshtatshëm për kohën e vet, por nuk mund të jetë i tillë për çdo kohë. Kjo krenari është vetëm e Kuranit Famëlartë.

Në Kuran Allahu i Madhërishëm ka lënë shërim për çdo sëmundje, dhe edukim për çdo aftësi. Çdo ligësi që ka vënë në dukje, Kurani ka treguar edhe metodën për ta larguar atë. Prandaj, lexoni shpesh Kuranin Famëlartë dhe lutuni. Përpikuni që të përshtatni sjelljen tuaj sipas mësimave të tij”.⁶

Hazret Mesihu i Premtuar ^{a.s.} gjithashtu tha:

“Lexoni Kuranin e Shenjtë duke e medituuar dhe duke e përsiatur. Në hadith thuhet:

رَبِّ قَارِيْ يُلْعَنُ الْقُرْآنُ

“Ka plot recitues të Kuranit, të cilët Kurani i mallkon”.

Ai që lexon Kuranin dhe e praktikon atë, Kurani i Shenjtë e mallkon atë. Gjatë leximit të Kuranit, kur hasni ajete që flasin për mëshirën e Zotit, aty kërkojini mëshirë Zotit. Dhe aty ku hasni ajete që flasin për ndëshkimin mbi ndonjë popull, kërkojini me përlulësi Zotit mbrojtjen nga ndëshkimi i Tij. Pra, Kuranin lexojeni me vëmendje, që ta praktikoni atë”.⁷

Hazret Abdullah ibni Mes’udi ^{r.a.} rrëfen se i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} tha:

“Ai që lexoi qoftë një shkronjë të Kuranit, atij do t’i shkruhet shpërblim për një mirësi, dhe kjo mirësi do t’i sjellë dhjetë mirësi të tjera”.

Më pas, Profeti ^{s.a.v.s.} tha:

“Nuk them se Elif.Lam.Mim është një shkronjë, por elifi, lami dhe mimi llogariten nga një shkronjë veç e veç”.⁸

Po Hazret 'Abdullah ibni Mes’udi ^{r.a.} rrëfen:

“Ai që lexon 50 ajete të Kuranit gjatë natës, nuk do të llogaritet ndër njerëzit e pavëmendshëm”.⁹

Duke porositur të lexojmë Kuranin Famëlartë rregullisht në shtëpi, i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} tha:

“Lexoni shpesh Kuranin e Shenjtë në shtëpi. Pa dyshim, shtëpia në të cilën nuk lexohet Kurani, ka mbarësi më pak dhe prapësi më shumë. Ajo shtëpi bëhet e ngushtë për banorët e saj”.¹⁰

Hazret Mesihu i Premtuar ^{a.s.} tha:

“Adhurimi qëndron në recitimin e Fjalës së Zotit, sepse i dashuruari i vërtetë patjetër gëzohet dhe çmallet kur lexon ose dëgjon Fjalën e të Dashurit”.¹¹

Hazret Ebu Umame el-Bahili ^{r.a.} rrëfen:

“E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut ^{s.a.v.s.} duke thënë: Lexoni shpesh Kuranin e Shenjtë, sepse Ditën e Gjykimit ai do t’i ndërmjetësojë lexuesit e vet”.

Profeti ^{s.a.v.s.} gjithashtu tha:

“Lexoni shpesh suren El-Bekare, sepse praktikumi mbi të ju sjell bekime dhe heqja dorë nga ai ju shkakton dëshpërime. Asnjë kundërshtar nuk mund ta rrëzojë dot atë”.¹²

Hazret Mesihu i Premtuar ^{a.s.} tha:

“Një mësim i rëndësishëm për ju është që të mos e lini Kuranin Famëlartë si të braktisur, sepse pikërisht në të gjendet jeta juaj. Ata që nderojnë Kuranin, do të nderohen në qiell. Dhe ata që Kuranit i japin përparësi mbi çdo hadith dhe

mbi çdo thënie tjetër, atyre do t'u jepet përparësi në qiell. Nuk ka më libër tjetër në faqen e dheut për njerëzimin, përveç Kuranit. Dhe nuk ka më ndërmjetësues tjetër për të gjithë bijtë e Ademit, përveç Muhammedit të Zgjedhur *sal-lal-llahu alejhi ve sel-lem*".¹³

Ai gjithashtu tha:

"Sinqerisht ju them të vërtetën, nëse nuk i shmanget Kuranit, as fjalës së tij e as kuptimit të tij, Allahu i Madhërishëm vendos një dallim (furkan) mes atij dhe të tjerëve; ai do të ketë besim dhe bindje të përsosur në Zotin e Madhërishëm; ai do të shohë çudirat e krijimtarisë së Zotit; atij do t'i shtohet njohja ndaj Zotit; shpesh do t'i pranohen lutjet; atij do t'i dhurohen aftësitë dhe ndjesitë, me të cilat ai arrin të zbulojë sekretet e krijimtarisë së Zotit që të tjerët nuk arrijnë t'i zbulojnë dhe ai do të fillojë të dëgjojë atë që të tjerët nuk kanë haber për të".¹⁴

SHËNIME

1. *Xhami'u et-Tirmidhi*, Kitab: "*El-Kira'at*", Bab: "*Ma xhae unzilel-Kuranu 'ala sab'ati abrufin*", hadithi nr. 2949.

2. Kurani Famëlartë 2:122.

3. Kurani Famëlartë 17:79.

4. *Sabih el-Buhari*, Kitab: "*Fedailul-Kur'an*", Bab: "*Fi kem jukreul-Kuranu*", hadithi nr. 5054.

5. Kurani Famëlartë 73:5.

6. "*Melfuzat*", vëll. 5, f. 102.

7. "*Melfuzat*", vëll. 5, f. 157.

8. *Xhami'u et-Tirmidhi*, Kitab: "*Fedailul-Kur'an*", Bab: "*Ma xhae finen kare'e harfen minel-Kur'ani ma lehu minel-exbri*", hadithi nr. 2910.

9. *Sunen Ed-Darimi*, Kitab: "*Fedailul Kuran*", Bab: "*Men kare'e khamsine ajeten*", hadithi nr. 3489.

10. Alaud-din el-Mut-teki el-Hindi, "*Kenzul-'Ummal*", "*Fasluth-thani fi adabil-bejti vel-binai*", vëll. 15, Botues: "*Muessesetur-Risaleh*", Bejrut 1405h/1985m, f. 388, hadithi nr. 41496,

11. "*Surma Çashma-e-Arje*", "*Ruhani Khazain*", vëll. 2, f. 283.

12. *Sabih Muslim*, Kitab: "*Es-Salatul-Musafirine ve kasriha*", Bab: "*Fadli kiraetil-Kurani ve suretil-Bekareti*", hadithi nr. 1874.

13. "*Kashti-e-Nuh*", "*Ruhani Khazain*", vëll. 19, f. 13.

14. Gazeta "*El-Hakam*", 17 gusht 1905, f. 5.

Çfarë janë engjëjt ose melekët?

Hazret Mirza Tahir Ahmed ^{r.a.}

Kalifi i Katërt i Mesihut të Premtuar

Ekzistenca e engjëjve është një doktrinë universalisht e pranuar në vende dhe në fe të ndryshme. Megjithatë, engjëjt nganjëherë diskutohen me tituj të ndryshëm, duke qenë vetëm një dallim të nomenklaturës. Po ashtu, natyra e tyre është kuptuar ndryshe nga ithtarët e feve të ndryshme.

Islami flet për engjëjt të jenë si qenie qiellore me natyrë shpirtërore, të cilat ekzistojnë si persona. Rolin kryesor që luajnë ata, është t'u transmetojnë mesazhin e Zotit qenieve njerëzore. Por, ata u keqkuptuan nga shumë njerëz, madje edhe nga muslimanët, që ata kanë fizionominë e njerëzve apo kanë ndonjë trajtë apo formë, që në realitet është një ide e pandashme nga ajo e ekzistencës materiale.

Materia patjetër duhet të ketë ndonjë trajtë dhe kufi të caktuar. Por, shpirti qëndron përtej pesë dimensioneve të të kuptuarit të njeriut. Dikush mund të besojë në ekzistencën e shpirtit vetëm nëse është një person fetar, përndryshe është përtej kapjes së tij ta përfytyrojë trajtën dhe formën e shpirtit.

Ndoshta për ta zgjidhur këtë problem dhe për t'ia bërë lehtë njeriut t'i përfytyrojë engjëjt, disa herë në librat fetarë përmendet që ata u paraqiten njerëzve të shenjtë në formën e qenies

njerëzore. Jo vetëm kaq, ata gjithashtu njihen se u janë paraqitur disa profetëve të Zotit në formë të zogjve. Shpirti i shenjtë i ishte paraqitur Jezusit në formën e një pëllumbi:

“Dhe Jezusi, sapo u pagëzua, doli nga uji; dhe ja, qiejt iu hapën, dhe ai pa Shpirtin e Perëndisë duke zbritur si një pëllumb e duke ardhur mbi të”. (Mateu 3:16)

Këto referime që gjenden në librat fetarë, ndoshta janë shkaqe kryesore për keqperceptimin lidhur me formën dhe natyrën e engjëjve, që janë përhapur ndër ithtarët e feve të ndryshme. Ndër engjëjt, në disa fe, u morën si zota dhe perëndi, kurse librat origjinalë mund t'i kenë përmendur vetëm si ndërmjetës posaçërisht të krijuar nga Zoti për të kryer disa detyra të veçanta në univers. Për këtë, kemi dëshmi të mjaftueshme në shumë libra hyjnorë. Pra, nuk është e pabesueshme që disa njerëz e keqkuptojnë rëndësinë e këtyre deklaratave dhe fillojnë t'i trajtojnë engjëjt si partnerë të rinj të Zotit.

Çfarë janë melaqet sipas Islamit?

Tani, le të bëjmë përpjekje për të kuptuar natyrën e engjëjve vetëm në bazë të referimeve të Kuranit Famëlartë dhe të thënieve të Hazret Profetit të Islamit s.a.v.s., dhe jo në bazë të pikëpamjeve

përgjithësisht të mbajtura.

Sipas Kuranit, i tërë universi material, po ashtu edhe ai fetar qeveriset me anë të disa forcave shpirtërore, të cilat referohen si engjëj. Ndonëse, disa engjëj përmenden si një person, siç janë: Xhibraili, Mikaili apo Azraili, në të vërtetë, ata nuk veprojnë vetëm. Për çdo detyrë ka një lider apo një engjëll suprem, që qeveris atë detyrë të caktuar dhe nën të, punojnë një varg engjëjsh, të cilët në Kuranin e Shenjtë përmenden si Xhunud (ushtri) të Zotit. Çfarëdo pune ata kryejnë, i nënshtrohen tërësisht dëshirës së Zotit dhe planit që Ai ka krijuar për gjërat. Ata nuk mund të devijohen aspak nga rruga që u është përcaktuar për ta kryer detyrën e tyre, ose nga plani i përgjithshëm i sendeve, i hartuar prej Zotit.

Sipas Kuranit të Shenjtë, për secilin njeri, janë të caktuar dy engjëj që i shënojnë veprat e mira dhe ato të këqija, sipas rastit që mund të jetë. Në këtë rast, detyra e engjëjve është ta organizojnë sistemin më të ndërlikuar dhe më të thellë të regjistrimit. Kjo nuk do të thotë se secili prej tyre ka një dosje në dorë duke shënuar gjithçka që vëren.

Në të vërtetë, engjëjt janë përgjegjës të një sistemi mjaft të komplikuar, atij të regjistrimit të efekteve të veprave të njeriut në shpirtin dhe në personalitetin e tij. Kështu që, një njeri i mirë zhvillon një



shpirt të shëndoshë dhe një njeri i keq mban një shpirt jo të shëndoshë.

Shpirti, siç e merr formën te çdo njeri, deri në vdekjen e tij, ka nevojë për një organizator të vetëdijshëm, i cili shpirtit ia transferon dhe zhbart efektet e mendimeve dhe veprave të njeriut etj.. Ky është një proces i ndërlikuar dhe që nuk mund të kapet plotësisht nga njeriu. Megjithatë, këtë e dëshmojmë pjesërisht në rastin e kriminelëve, të cilët pësojnë një formë të ndryshme nga ajo që përfitojnë ata që bëjnë vepra fisnike. Kjo nuk është e pamundur aspak për dikë ta vërej një diferencë të tillë, megjithëse kjo nuk mund të shpjegohet në terma të qarta, sikur e bardhë dhe e zezë ose në terma të tjera materiale.

Faktikisht, administrimi i gjithësisë madhështore, fill pas zanafillës dhe gjatë tërë fazës së saj miliarda vjeçare, që ka një histori të gjatë të evolucionit, kërkon një organizim madhor të vëmendjes dhe të kontrollit konstant. Ky proces kryhet përmes engjëjve të panumërt, të cilët, si agentë të Zotit, në kuptimin e drejtpërdrejtë e qeverisin universin e madh dhe sistemin e tij tejet të ndërlikuar të ligjeve.

Për sa u përket thënieve të Hazret Profetit të Islamit ^{s.a.v.s.}, deri në një shkallë, ne mund ta kuptojmë shumanshmërinë e engjëjve, që ata mund të materializohen në forma e në shfaqje të ndryshme, të cilat nuk kanë lidhje me formën apo ekzistencën e tyre reale, pasi ata janë përtej perceptimit të njeriut dhe kanë dimensione të tjera nga ato që njihen prej nesh.

Rrëfehet, se një herë, në i huaj papritmas hyri në xhami ku Themeluesi i Islamit ^{s.a.v.s.} që i ulur bashkë me sahabët e tij. Njeriu i sapohyrë iu afrua xhematit, u ul me respekt në rreshtin e parë dhe filloi të shtrojë pyetje lidhur me natyrën e Islamit. Sa i dha fund listës së pyetjeve, ai kërkoi leje dhe shkoi. Të pranishmit u habitën, sepse së pari ai ishte plotësisht një i huaj, i cili duhet të ketë udhëtuar nga një distancë e largët për të ardhur deri në xhami.

Në vendbanime të vogla, njohja e vizitave të tilla nuk mbetet sekrete dhe çdo njeri di se kush dhe për çfarë qëllimi ka ardhur. Por, në rastin e tij, ardhja ishte aq papritmas sa që iu duk shumë misterioze. Së dyti, ai nuk kishte asnjë shenjë udhëtimi, as në rrobat e tij. Ishte një zotëri që dukej i freskët, me rroba shumë të pastra. Veç kësaj, mënyra e tij e të shtruarit të pyetjeve, pa ndonjë prezantim, si dhe largimi i tij i papritur, ishin krejtësisht të pazakonta.

Para se të thoshin diçka sahabët e Profetit ^{s.a.v.s.}, vetë i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} i informoi që zotëria, në të vërtetë, ishte engjëlli Xhibrail, i cili bëri disa pyetje me qëllim që sahabët të informohen rreth atyre fakteve që gjendeshin në përgjigjet e tyre. Disa sahabë dolën me vrap nga xhamia që të takohen me engjëllin e maskuar, siç e mendonin ata, por atje nuk kishte asnjë gjurmë të tij. Asnjëri në atë vendbanim nuk deklaroi se e ka parë atë njeri më përpara.

Meqë kjo ngjarje është rrëfyer në librat më autentikë të thënieve (haditheve) të të Dërguarit të Allahut ^{s.a.v.s.}, ne mund të

nxjerrim një përfundim shumë lehtë që, engjëjt nganjëherë paraqiten në formën e njeriut për të kryer detyra të ndryshme. Gjejmë përmendjen e engjëjve në shumë hadithe të tjera, veçanërisht në lidhje me betejën e Bedrit dhe të Uhudit, por, ndoshta do të jetë e papërshtatshme të shtjellohen raste të tilla këtu, sepse kjo do ta zgjasë shumë ligjërimin tonë.

Pra, përkundër pikëpamjes së Kuranit të përmendur më lart, gati në të gjitha vendet, pikëpamja përgjithësisht e dominuar rreth engjëjve ndër ithtarët e feve të ndryshme është më shumë sipas modelit të zanave përrallore se sa të formës qiellore. Thuhet se ata kanë krahë si zogj apo si zana, dhe i përplasnin për të fluturuar nga një vend në një vend tjetër. Ky koncept i gabueshëm ndoshta ka lindur për shkak të përdorimit të termave fetarë në kuptimin e tyre tepër të drejtpërdrejtë, të cilat janë të fshehta dhe, në shumë raste, janë aluzione metaforike. Kështu, ne gjejmë edhe në Kuranin Famëlartë ajete ku flitet rreth krahëve të engjëjve se ata kanë dy, tre apo katër krahë:

“Lavdërimi i takon Allahut, Krijuesi i qiejve dhe i tokës, i Cili i ka bërë engjëjt të dërguar me nga dy, tre ose katër krahë”. (El-Fatir 35:2)

Kurani i Shenjtë ka një stil shumë të veçantë të sqarimit dhe të ndriçimit të të gjitha fragmenteve të tilla ku ekziston ndonjë rrezik i paqartësisë. Këtë punë ai e bën me përdorimin e fragmenteve të ngjashme me konotacione të ndryshme. Për sa u përket krahëve, për shembull, ne gjithashtu gjejmë përdorimin e

kësaj fjale lidhur me sjelljet e një djali ndaj prindërve të tij të moshuar. Duke trajtuar këtë temë, Kurani Famëlartë e këshillon djalin t'i shtrojë krahët e tij të mëshirës ndaj prindërve të tij, sepse ata e rritën që nga koha e foshnjërisë së tij. Pra, krahë do të thotë vetëm atribut dhe fuqi, dhe ne besojmë se në këtë kuptim kjo fjalë u atribuohet engjëjve apo personave që deklarojnë manifestimin hyjnor në fe të ndryshme. Për shembull, në Gita, Krishna, në vend të dy krahëve, përmendet të ketë katër. Edhe atje, një palë shtesë e krahëve ka të njëjtin qëllim që ekziston në librat e tjerë hyjnorë.

Engjëjt janë përgjegjës për kontrollimin dhe mirëmbajtjen e ligjeve të natyrës. Viruset dhe bakteret gjithashtu qeverisen, organizohen dhe mirëmbahen prej engjëjve të caktuar, të cilët punojnë në harmoni me njëri-tjetrin për të mbajtur gjërat në ekuilibër të përsosur. Në të njëjtën mënyrë, edhe eko-sistemet nuk janë aksidentale apo kaotike, por janë të rregulluara nga qenie të padukshme shpirtërore, të cilat ne i quajmë engjëj.

Rasti i engjëllit të rrëzuar

Ka edhe një episod mjaft të keqkuptuar lidhur me Shejtanin. Thuhet dhe besohet se Shejtani para rrëzimit apo degradimit të tij i përkiste kategorisë së engjëjve. Kurani Famëlartë e hedh poshtë këtë mendim dhe Shejtanin e prezanton si qenie që posedon një natyrë zjarri. Pra, ai u takon formave të jetës që janë të krijuara nga zjarri, si për shembull xhindët.



EMRAT E ALLAHUT





1. ALLAHU

قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ اللَّهُ الصَّمَدُ لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ

Thuaj: “Ai, Allahu është i Vetëm! Allahu është i Pavaruri., të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim. Ai as nuk lind, as nuk është i lindur. Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë!”¹

Allahu është një emër unik që gjendet vetëm në Islam. Allahu është emri i qenies hyjnore, i cili ka ekzistuar në amshim, dhe është i përjetshëm. Ai është i Gjallë, i Vetëmjatushëm dhe Mbajtësi i gjithëçkaje. Ai është Zoti, Krijuesi dhe Sunduesi mbi çdo krijesë. Përveç kësaj, ky është emri i përveçëm i Zotit dhe jo një emër cilësor. Përveç arabishtes, në asnjë gjuhë tjetër, nuk ekziston një emër i përveçëm, që i përgjigjet posaçërisht qenies që ka krijuar gjithçka dhe sundon mbi çdo gjë. Është vetëm gjuha arabe, në të cilën fjala “Allah” përdoret si një emër i përveçëm që i referohet Atij që është Një dhe i Vetëm. Kjo fjalë e veçantë i

përgjigjet vetëm emrit të Zotit.

Me të vërtetë, fjala “Allah” nuk buron nga ndonjë fjalë tjetër dhe as nuk rrjedhin fjalë të tjera prej saj.²

I Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} ia ka përshkruar veçorinë dhe shquarsinë këtij emri të Zotit, me këto fjalë:

عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ بَرْيَدَةَ الْأَسْلَمِيِّ، عَنْ أَبِيهِ، قَالَ سَمِعَ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ رَجُلًا يَدْعُو وَهُوَ يَقُولُ اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ بِأَنِّي أَشْهَدُ أَنَّكَ أَنْتَ اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ الْأَحَدُ الصَّمَدُ الَّذِي لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ . قَالَ فَقَالَ ” وَالَّذِي نَفْسِي بِيَدِهِ لَقَدْ سَأَلَ اللَّهُ بِاسْمِهِ الْأَعْظَمِ الَّذِي إِذَا دُعِيَ بِهِ أَجَابَ وَإِذَا سُئِلَ بِهِ أُعْطِيَ “

‘Abdullah ibn Burejdah el-Eslemiu^{r.a.} transmeton nga babai i tij se i Dërguari i Allahut^{s.a.v.s.} dëgjoi dikë duke u lutur me këto fjalë: “O Allah! Po Të lutem në saje të emrit Tënd të pastër, të dëlirë, të bekuar, të dashur për Ty, me të cilin kur njeriu Të lutet, i përgjigjesh; kur Të kërkon diçka, ia jep; kur Të kërkon mëshirë, e mëshiron; dhe kur Të kërkon t’i plotësosh ndonjë nevojë, ia plotëson”. Atëherë i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} u shpreh: Beto hem në Allah, i cili posedon shpirtin tim, me të vërtetë ai i është lutur Allahut, duke përdorur emrin e Tij më të lartë. Nëse dikush i thërret Atij me këtë emër, Ai i përgjigjet, dhe kur i kërkohet diçka, ia jep”.³

Çdo përsosmëri i përket Allahut

Në gjuhën e Kuranit Famëllartë, Allahu është qenia e përsosur që adhurohet me

të drejtë, i cili zotëron çdo atribut të përsosur dhe është i pastër nga çdolloj mangësie a dobësie. Ai është i Vetëm e i Pashoq dhe është burimi i çdo mirësie. Zoti i Madhërishëm, në fjalën e Tij të shenjtë, Kuranin Famëlartë, e ka cilësuar emrin “Allah” si përmbledhës dhe mishërim të të gjitha attributeve të tjera, dhe këtë status nuk i ka akorduar asnjë emri tjetër. Prandaj, emri Allah gëzon epërsi mbi atributet e tjera, të cilat i përfshin brenda vetes. Meqë, ky emër është barasvlerës me emra dhe veti të tjera, prandaj përmban të gjitha vetitë e mira e të përsosura.

Kështu, kuptimi i termit Elhamdulillah (Lavdia është e Allahut) është që çdolloj lavdie, qoftë ndaj aspekteve të jashtme apo ndaj realiteteve të brendshme, qoftë ndaj përsosmërive të trashëguara apo ndaj atyre të shfaqura në fenomenet e natyrës, i përket vetëm Allahut. Asnjë emër nuk bën pjesë në këtë epërsi. Çfarëdo lavdie të vërtetë apo përsosmërie të pashoqe që mund të rrokë urtësia e mendimtarëve apo që mund të perceptohet nga mendja e intelektualëve, i përgjigjet vetëm Allahut, Zotit të Plotfuqishëm. Nuk ka përsosmëri, në të cilën mund të përsiatet arsyeja e shëndoshë dhe të mos gjendet në qenien e Allahut.

Me fjalë të tjera, arsyeja nuk mund të përfytyrojë ndonjë përsosmëri që nuk

është e gërshetuar në atributet hyjnore. Ai zotëron çdo përsosmëri që dikush mund të marrë me mend dhe është i Përkryer në çdo aspekt në Qenien, atributet dhe cilësitë e Tij dhe është plotësisht i pastër nga çdo e metë dhe mangësi.⁴

SHËNIME

1. Kurani Famëlartë 112:2-5.
2. Hazret Mirza Bashiruddin Mahmud Ahmed ^{ra}, “*Tefsir-e-Kabir*”, vëll. 1, f. 11-12.
3. *Xhami’u et-Tirmidhi*, Kitab: “*Ed-Da’vat*”, Bab: “*Xhami’ id-Da’vati ‘anin-nebiji sal-lall-llahu ‘alejhi ve sel-lem*”, hadithi nr. 3475.
4. Hazret Mirza Ghulam Ahmed ^{as}, “*Berabin-e-Ahmedia*”, pjesa IV “*Ruhani Khazain*”, vëll. 1, (Islam Int. Publications Ltd., 2016), f. 364-365, fusnota 11.



2. I GJITHËMËSHIRSHMI (ER-RAHMAN)

الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ - الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ -

Lavdia është e Allahut, Zotit të botëve; të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.¹

Fjala Er-Rahman الرَّحْمَن është një ndër atributet e Zotit të Plotfuqishëm që përdoret posaçërisht për t'iu referuar Atij e jo dikujt tjetër. Kjo fjalë buron nga gjuha arabe dhe rrënja e saj është Ra-Hi-Me-hu رَحِمَ që do të thotë të rrënjosësh në zemrën e dikujt ndjenja dhembshurie për dikë, të falësh dikë dhe të kesh dashamirësi ndaj tij. I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka shtjelluar këtë atribut në një hadith të njohur:

عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ - رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ - عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ
"إِنَّ الرَّحْمَنَ نُجْنَةُ مِنَ الرَّحْمَنِ، فَقَالَ اللَّهُ مَنْ وَصَلَكَ وَصَلْتُهُ، وَمَنْ
قَطَعَكَ قَطَعْتُهُ".

Transmetohet nga Ebu Hurejre^{r.a.} se i Dërguari i Allahut^{s.a.v.s.} ka thënë: "Fjala الرَّحْمَن Er-Rahime (mitër) rrjedh nga Er-Rahman, rreth të cilit Allahu ka thënë: "Unë do të kem lidhje me atë që është i lidhur me ty (me familjen e farefisin) dhe do të prish lidhje me atë që ka prishur lidhje me ty (me familjen e farefisin)."²

Rahmanijet - Mëshira gjithëpërfshirëse e Zotit të Madhërishëm

"Atributi i dytë i Zotit të Plotëfuqishëm, i cili përbën mirësinë e Tij në shkallën e dytë është Rahmanijet (mëshirë

gjithëpërfshirëse). Ajo gjithashtu mund të cilësohet si mëshirë e përgjithshme, e cila është përshkruar në suren el-Fatiha me emrin Er-Rahman (i Gjithëmëshirshëm). Sipas Kuranit Famëlartë, Zoti i Madhërishëm quhet Er-Rahman sepse Ai i ka dhënë çdo krijese përfshirë njeriut, formën dhe cilësitë e duhura. Kjo nënkupton që njeriut i janë dhënë aftësitë, fuqitë, trajta e gjymtyrët që i përshtaten mënyrës së jetës që është caktuar për të, dhe të cilat u përgjigjen më së miri nevojave të tij. Ai është pajisur me çdo gjë që i nevojitet për zhvillim të gjithanshëm të tij.

Shpendëve, kafshëve, njeriut, të gjithëve u janë dhuruar fuqitë e duhura. Madje, mijëra vite përpara ekzistencës së këtyre krijesave, Zoti i Plotfuqishëm, në saje të atributit të "mëshirës gjithëpërfshirëse", ka krijuar trupa qiellorë dhe tokësorë, me qëllim që të shërbejnë si mbrojtës për to. Kjo tregon se askush nuk ka ndërhyrë për të shkaktuar mëshirën e Tij gjithëpërfshirëse. Mëshira absolute e Zotit u vë në lëvizje shumë kohë përpara se të krijoheshin gjallesat. Njeriu është përfutuesi më i madh i atributit Rahman të Zotit të Madhërishëm, sepse çdo krijesë tjetër nënshtrohet për mbarëvajtjen e tij. Prandaj, njeriut i është bërë thirrje që Zoti i tij është Er-Rahman - i Gjithëmëshirshëm".³

1. Kurani Famëlartë 1:2-3.
2. “*Sabih el-Buhari*”, Kitab: “*El-Edeb*”, Bab: “*Men vesale vesalebull-llab*”, hadithi nr. 5988.
3. Mirza Ghulam Ahmed ^{a.s.}, “*Ejjaamus-Suleb*”, Ruhani Khazain, vëll. 14, f. 248-249.



3. MËSHIRËBËRËSI (ER-RAHIM)

الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ - الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Lavdia është e Allahut, Zotit të botëve; të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit.¹

Fjala Er-Rahim الرَّحِيم vjen nga gjuha arabe me rrënjë Ra-Hi-Me رَحِم. Ajo nënkupton përsëritjen, si dhje të shpërblesh dikë sipas asaj që i takon.² Pra, Er-Rahim është ai që i bën mirësi e i jep shpërblim atij që meriton. Rahim është ai që ka brumosur veten me frymën e mëshirës, dhe ai që përfiton nga kjo mëshirë.³ I Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} ka shtjelluar këtë atribut të Zotit në një hadith. Ai ka thënë:

عَنْ صَفْوَانَ بْنِ مُحَرَّرٍ، أَنَّ رَجُلًا سَأَلَ ابْنَ عُمَرَ، كَيْفَ سَمِعْتَ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ فِي الْحُجُوعِ؟ قَالَ: يَدْعُو أَحَدَكُمْ مِنْ رَبِّهِ حَتَّى يَضَعَ كَتِفَهُ عَلَيْهِ، فَيَقُولُ: “عَمِلْتَ كَذَا وَكَذَا”، فَيَقُولُ: نَعَمْ، وَيَقُولُ: “عَمِلْتَ كَذَا وَكَذَا” فَيَقُولُ: نَعَمْ، فَيَقْرَأُ، ثُمَّ يَقُولُ: “إِنِّي سَمِعْتُكَ عَلَيْكَ فِي الدُّنْيَا فَأَنَا أَعْفُوهَا لَكَ الْيَوْمَ”

Hazret Safvan ibn Muhrizi^{r.a.} transmeton se njëherë një person e pyeti Ibn Omerin^{r.a.}: “Çfarë keni dëgjuar nga i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} lidhur me Nexhva (d.m.th. biseda e fshehtë e cila do të zhvillohet në ditën e Gjykimit, midis Zotit dhe robit mëkatar)? Ai iu përgjigj: I Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} ka thënë që atë ditë do të paraqitet një rob para Zotit. Zoti do t’ia vërë dorën në qafë dhe do të pyesë: “A ke kryer filan a filan mëkat?” Ai do të pranojë duke thënë “Po”. Zoti do t’ia pyesë sërish: “A e ke kryer këtë e këtë mëkat?” Në këtë mënyrë, Zoti do ta bëjë robin të pranojë (të gjitha mëkatet e tij) e pastaj do t’i thotë: “Unë kam mbuluar mëkatet e tua për ty në botë, ndërsa sot Unë po i fal të gjitha”.⁴

Rahimijet – Mirësia e veçantë e Zotit ndaj njeriut

“Atributi i tretë i Allahut, i cili përbën mirësinë e Tij në shkallën e tretë quhet Rahimijet dhe për këtë arsye Ai është quajtur er-Rahim në suren El-Fatiha. Sipas shprehjes idiomatike të Kuranit Famëlartë, Zoti i Madhërishëm quhet er-Rahim, kur Ai u pranon njerëzve lutjet, përgjërimit dhe veprat e mira, i

mbron ata nga fatkeqësitë, nga gjëmat dhe nga dështimi i përpjekjeve. Kjo mirësi përkufizohet gjithashtu si një hijeshi e veçantë që i përgjigjet vetëm njerëzimit. Krijesave të tjera, Zoti nuk u ka dhënë aftësinë e lutjes, përgjërimit dhe veprave të dëlira, ndërsa njeriut i ka dhuruar të gjitha këto. Njeriu gëzon aftësinë e të folurit, ndërsa të tjerët nuk e kanë këtë dhe duke ushtruar këtë aftësi, ai mund të fitojë mirësinë hyjnore. Kjo bën të qartë se të luturit është vetia e njerëzores, që njeriu e ka trashëguar si pjesë të qenësishme”.⁵

Mesihu i Premtuar ^{a.s.} gjithashtu ka thënë:

“Dallimi midis mëshirës gjithëpërfshirëse (Rahmanijet) dhe mëshirës së veçantë (Rahimijet) është që veprat dhe përpjekjet nuk kanë lidhje me të parën, ndërsa për ta tërhequr të dytën, ato luajnë një rol të rëndësishëm. Megjithatë njeriun e shoqëron dobësia, kurse mëshira e Zotit do që t’i mbulojë të metat e njeriut”.⁶

SHËNIME

1. Kurani Famëlartë 1:2-3.

2. Ebu Hajjan el-Endelusi, “*Tefsir el-Babrul Muhit*”, vëll. 1, botues: “*Kutub el- Ilmijje*”, Bejrut, 1413h./1993, f. 125.

3. Sa’id el-Khuri Esh-Shertuni, “*Akrabul Mevarid fi Fus’hil Arabijjeti*

vesh-Shevvario”, vëll. 1, zëri: Ra-Ha-Mīm (ح), Kum, Iran, 1403h./1983, f. 395-396.

4. “*Sahih el-Buhari*”, kitab: “*el-Edeb*”, bab: “*Setril-Mu’mini ‘ala nefsibi*”, hadithi nr. 6070.

5. Hazrat Mirza Ghulam Ahmad^{a.s.}, “*Ejjaamus Suleb*”, “*Ruhani Khazain*”, vëll. 14, f. 249, Islam International Publications Ltd., 2017.

6. “*Melfuzat*”, vëll. 1, f. 127.



5. EL-MELIK (SUNDUESI)

مَالِكِ يَوْمَ الدِّينِ

Sunduesi i Ditës së Gjykimit.¹

Fjala Mālik i referohet atij i cili me të drejtë zotëron diçka dhe ushtron autoritet mbi të. Kjo fjalë mund të përdoret edhe për atë, i cili lëshon urdhra sipas vullnetit të tij të cilëve të tjerët duhet t’u nënshtrohen. El-Mulk الملِك nënkupton ushtrimin e autoritetit

mbi diçka, të cilën njeriu e zotëron dhe sundon plotësisht. Kështu atributi Mālik i Jeumid-dīn do të thotë që Zoti i Madhërishëm është Sunduesi i Ditës së Gjykimit.² Në një hadith të njohur, i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} ka thënë:

عَنْ أَبِي سَلَمَةَ، أَنَّ أَبَا هُرَيْرَةَ، قَالَ سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ " يَقْبِضُ اللَّهُ الْأَرْضَ، وَيَطْوِي السَّمَوَاتِ يَمِينَهُ، ثُمَّ يَقُولُ أَنَا الْمَلِكُ، أَيْنَ مُلُوكُ الْأَرْضِ."

Hazret Ebu Seleme ^{r.a.} transmeton nga Hazret Ebu Hurejre ^{r.a.}, i cili ka thënë se ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut ^{s.a.v.s.} duke thënë: "Allahu do të mbërthejë tokën, dhe do t'i palosë qiejt me dorën e Tij të djathtë, dhe pastaj do të deklarojë "Unë jam Mbreti. E ku janë mbretërit e tokës?"³

Zoti i Plotfuqishëm: Sunduesi i të gjithë sovranëve

"Mirësia e katërt e Zotit të Madhërishëm, e cila ndoshta mund të quhet hijeshia më e veçantë, është Mālikijet (sundimi) mbi Ditën e Gjykimit, dhe falë këtij atributi, Ai është quajtur Mālik i Jeumid-dīn në suren El-Fatiha. Dallimi midis këtij atributi dhe Rahimijet është që përmes lutjes dhe adhurimit, atributi Rahim e aftëson njeriun të arrijë qëllimin e tij, kurse atributi Malik i jep shpërblim. Kjo i shëmbëllen një nxënësi i cili merr provimin me sukses pas një pune këmbëngulëse. Të presësh një sukses të merituar përmes ndikimit të atributit

Rahim, i ngjan marrjes së provimit nga nxënësi, ndërsa fitorja dhe arritja e synimit kryesor për të cilin ai kishte dhënë provimin, i ngjan shpërblimit që fitohet përmes atributit Mālik. Këto dy attribute tregojnë që dhuntitë e lidhura me Rahimijet mund të fitohen përmes mëshirës së Zotit dhe favoret e atributit Mālik jaumid-dīn mund të arrihen me anë të mirësisë së Tij. Ndonëse Mālikijet jeumid-dīn do të shfaqet në mënyrë të plotë e të gjithanshme në botën e përtejme, këto katër attribute manifestohen edhe në këtë botë".⁴

SHËNIME

1. Kurani Famëllartë 1:4.
2. Er-Ragib el-Isfahani, "*Mufredat elfadhul-Kuran*", redaktor: Safvan 'Adnan, Davudi, botimi IV, boton: "Darul-Kalem", Damsk, 1430h./2009, zëri: Mim-Lam-Kef (ملك).
3. Sahih el-Buhari, kitab: "*et-Tefsir*", babi: "*Kaulihi: Vel-Erdu xhemi'an kabdatuhu jeumel-Kijameti...*", hadithi nr. 4812.
4. Hazret Mirza Ghulam Ahmed^{a.s.}, "*Ejjaamus Suleb*", "*Ruhani Khazain*", vëll. 14, f. 250, 251, Islam International Publications Ltd., 2016.

Përqendrimi në namaz

HAZRET MIRZA BASHIRUDDIN MAHMUD AHMEDI^{R.A.}

KALIFI I DYTË I MESIHUT TË PREMTUAR

Tani do t'u kthehem atyre metodave, që nuk renditen në kushtet e namazit e as nuk janë cekur nga sheriatit si pjesë përbërëse të adhurimit, por mund të ndihmojnë për të mbajtur përqendrim në namaz.


- Nëse nuk gjeni përqendrim në namaz, shqiptoni fjalët e namazit më ngadalë. Mendja njerëzore kujton më shpejt dukuritë që i has më shpesh, por has vështirësi për të kujtuar fenomene që i ndodhin rrallëherë. Nëse e takoni Agimin përditë, vetëm duke menduar për të, ju shfaqet pamja e tij. Por nëse e takoni rrallë, mendjes do t'i duhet kohë për t'ju nxjerrë në figurën e tij, edhe atë jo shumë të qartë. Në të njëjtën mënyrë, kur mësoni një gjuhë në fëmijëri, konceptet që lidhen me ato fjalë shfaqen menjëherë vetvetiu gjatë shqiptimit të fjalëve. Për shembull kur shqiptojmë fjalët “ujë” apo “bukë”, ato menjëherë riprodhojnë në mendje sendet apo dukuritë që ato shënojnë. Por kjo nuk ndodh me gjuhë të huaja. Mendjes i

duhet pak kohë për të krijuar imazhin që i përgjigjet fjalës. Kur fëmijët mësojnë anglisht dhe lexojnë fjalën “Cat”, ajo vlen vetëm si një fjalë. Por kur thuhet fjala “mace” në gjuhën amtare, që i përgjigjet fjalës “Cat”, mendja menjëherë shfaq një figurë të kësaj kafshe.

Mjaft muslimanë që nuk e njohin gjuhën arabe, nuk gjejnë përqendrim të plotë në namaz. Përqendrimi kërkon që përmbajtja kuptimore e fjalëve të pasqyrohet në mendje. Në mungesë të saj, ata nuk arrijnë të rrokin konceptet e ligjërimit. Ata mund të jenë duke lexuar ajetin e 4-të të sures el-Fatiha *Ij-jake na'budu* (Vetëm Ty të adhurojmë) ndërsa në mendje, shqyrtojnë ajetin e 2-të dhe përfytyrojnë kuptimin e fjalëve *Err-Rrahmanirr-Rrahim* (i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëbërsi). Si rrjedhojë, humbet përqendrimi gjatë namazit dhe zvogëlohet dobia e tij.

Për këtë arsye, nëse nuk zotëroni mirë gjuhën arabe, duhet të recitoni





fjalët më ngadalë. Derisa mendja juaj nuk ka kuptuar qartë përmbajtjen e fjalisë, nuk duhet të kaloni tutje. P.sh. duke shqiptuar fjalët *“Bismil-lahirr-Rrahmanirr-Rrahim”*, duhet të përsiatni thellë për të arritur përmbajtjen e fjalëve. Nuk duhet të vijoni me *“Elhamdu lil-lahi Rabbil-alemin”* (Lavdia është e Allahut, Zotit të botëve) derisa nuk ju kthjellohet përmbajtja e ajetit të mëparshëm. Kjo vlen edhe për fjalët vijuese – *Māliki Jeumid-din* (Sundues i ditës së Gjykimit). Derisa nuk përvetësoni shprehinë e të recituarit ngadalë, nuk mund të mendoni dot konceptet që lidhen me fjalët që shqiptoni.

Madje, kjo metodë e të recituarit ngadalë mund t’u sjellë dobi edhe atyre që kuptojnë arabisht. Ndonëse ata mund të krijojnë konceptet në mendjen e tyre më shpejt, recitimi i nxituar nuk do t’u japë kohë të mjaftueshme për të ngjallur ndjenjat në zemër. Edhe Kuranin Famëlartë duhet të lexojnë ngadalë dhe duke bërë pauza të shpeshta.

Recitimi i ngadaltë është një metodë e dobishme që vlen jo vetëm në leximin e Kuranit Famëlartë por edhe për ligjërimin e përgjithshëm gjatë predikimit a këshillimit. Njëherë Hazret Ebu Hurejre^{r.a.} po rrëfente një hadith me nxitim dhe me zë të lartë. Hazret Aisheja^{r.a.}, e cila po e dëgjonte, pyeti se kush ishte ai dhe çfarë po bënte? Ai ia kallëzoi emrin dhe tha se po rrëfente një thënie të të Dërguarit të Allahut^{s.a.v.s.}. Ajo e pyeti: “A bisedonte i Dërguari i Allahut^{s.a.v.s.} në këtë mënyrë?” Hazret Ebu Hurejre^{r.a.} heshti dhe nuk tha asgjë.

Me të vërtetë, i Dërguari i Allahut^{s.a.v.s.} fliste ngadalë, jo vetëm gjatë recitimit por edhe në biseda të përditshme. Ndiqni stilin e tij, kështu do të zhduket keqkuptimi midis fjalëve që shqiptoni dhe kuptimeve që krijohen në mendje. Kjo është një mënyrë e shkëlqyer për të arritur përqendrimin e vëmendjes.

- Kjo metodë buron nga i Dërguari i Allahut^{s.a.v.s.}. Ai na ka porositur që

gjatë namazit, duhet të përqendrojmë shikimin në vendin e sexhdes. Mjaft njerëz i shmangen kësaj porosie dhe nuk i çelin sytë gjatë namazit, duke kujtuar se mbyllja e syve ndihmon në gjetjen e përqendrimit. Ndërkohë, njeriu mund të gjejë përqendrimin edhe me sy të çelur. Prandaj, i Dërguari i Allahut^{S.A.V.S.} ka thënë që gjatë kohës së namazit, besimtari duhet të përqendrojë sytë në vendin ku bie në sexhde. Hazret Shihabudin Suhervardi¹ në librin e tij *'Avârif el-ma'ârif* (Njohësit e njohurive ose arifët e marifeteve) shkruan se gjatë rukusë (përkuljes) njeriu duhet të ngulë sytë te këmbët. Unë pajtohem me mendimin e tij, sepse kjo jo vetëm që u sjell dobi syve, por edhe njeriut i ngjall përulësi.

Përqendrimi i shikimit në një pikë të caktuar përmban urtësi të madhe. Është karakteristike për natyrën njerëzore se kur ndonjë shqisë i është përqendruar tërësisht në diçka, shqisat e tij të tjera gjithashtu shkëputen nga funksioni i tyre. Nëse sytë janë përqendruar plotësisht në diçka, shqisa e të dëgjuarit nuk funksionon plotësisht, dhe nëse dikush ju thërret në atë moment, ju nuk dëgjoni zërin e tij. Në të njëjtën mënyrë, nëse aftësia e të dëgjuarit është e përqendruar diku, shqisa e të nuhaturit nuk kryen detyrën e saj. Por, nëse të gjitha shqisat e njeriut janë të lira, mendime të ndryshme i sillen rrotull. Nëse, sytë janë plotësisht të

përqendruar gjatë namazit, mendja nuk mund të sillet rrotull.

Ky fenomen tashmë është vërtetuar nëpërmjet eksperimenteve në fushën e fiziologjisë. Le të ndalemi për një çast për të diskutuar se porosia që besimtari duhet të mbajë sytë hapur dhe të përqendrohet në vendin e sexhdes, e kishte dhënë i Dërguari i Allahut^{S.A.V.S.} para 1400 vjetësh, në një kohë kur shkenca ende nuk kishte zbuluar dobitë e saj.

Shqisa e të nuhaturit dhe të dëgjuarit nuk mund ta arrijnë këtë qëllim sepse shpesh ato veprojnë në mënyrë të pavetëdijshme. Për të bërë që aftësia e të nuhaturit gjithashtu të jetë e përqendruar, na duhet të disponojmë parfume të ndryshme. Por, nëse njerëzit që kalojnë pranë, përdorin parfume të tjera, atëherë vëmendja do të shpërndahet. Kjo vlen edhe për aftësinë e të dëgjuarit. Askush nuk mund të vendosë se çfarë do të dëgjojë e çfarë jo. Nëse në të njëjtën kohë, ngrihen tinguj të ndryshëm, njeriu është i detyruar t'i dëgjojë ata. Madje, në këtë rast, njeriu nuk mund të dëgjojë asnjë zë në mënyrë të qartë e të veçuar. Prandaj, nëse doni ta zbatoni këtë parim mbi shqisën e të dëgjuarit, do t'ju duhet të dëgjoni çdo tingull që ju bie në vesh ose nuk do të dëgjoni asgjë.

Në dallim me shqisën e të dëgjuarit dhe

të nuhaturit, njeriu mund të nënshtrojë shqisën e të parit. Ai mund të largojë sytë nga sendet, që nuk dëshiron të shikojë dhe mund të përqendrohet në ato objekte që i interesojnë atij. Prandaj duke ndjekur porosinë hyjnore, i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.}, zgjodhi pikërisht shqisën e të parit për të gjetur përqendrim në namaz.

I Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} gjithashtu ka thënë që vendi ku njeriu bie në sexhde duhet të jetë i thjeshtë e jo i stolisur dhe i zbukuruar. Nëse besimtari gjatë faljes fokusohet në vendin e sexhdes, ai mund të arrijë rezultate të dobishme. Duke kujtuar vazhdimisht për përkulje e gjunjëzim, ai arrin të mbledhë forcat mendore e të mbajë të ngulitur vëmendjen vetëm në adhurim. Ndërsa shqisat e tjera, që sipas rregullave duhet të jenë aktive ose të mbyllura, do të mbeten plotësisht të pezulluara. Ndikimet e jashtme formojnë mendimet tona, të cilat më pas perceptohen nga shqisat. Prandaj, njeriu do të jetë më i përqendruar në namaz, nëse vetëm sytë e tij janë në veprim, kurse shqisat e tjera janë në gjendje pasive.

عَنْ عَائِشَةَ، أَنَّ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ صَلَّى فِي حَمِيصَةٍ لَهَا أَعْلَامٌ، فَتَنَظَّرَ إِلَى أَعْلَامِهَا تَنْظُرَةً، فَلَمَّا انْصَرَفَ قَالَ " أَذْهَبُوا بِحَمِيصَتِي هَذِهِ إِلَى أَبِي جَهْمٍ وَأَتُونِي بِالنَّجَاحِيَّةِ أَبِي جَهْمٍ، فَإِنَّهَا أَلْهَيْتَنِي إِنَّمَا عَنْ صَلَاتِي "

Njëherë, një shtrojë e qëndisur ishte varur para vendit ku Profeti ^{s.a.v.s.} falte namaz. Me të mbaruar namazin, ai

porositi për ta hequr atë, sepse figurat e saj i tërhiqnin vëmendjen nga namazi.²

- Siç kam përmendur më parë që besimtari para se të fillojë namazin, duhet të bëjë nijet (qëllim) për të. Po ashtu është e dobishme, që ai të shprehë vendosmëri se nuk do të lejojë veten të rrëmbehet nga mendimet endacake. Ndonëse, çdonjeri e di se kësisoj mendimesh janë të padëshiruara, megjithatë ai e harron, andaj një kujtesë para çdo namazi sigurisht që do të jetë e dobishme.

- Duke u falur pas imamit, recitimi i tij gjithashtu na mban të vëmendshëm dhe të kujdesshëm në namaz. Në këtë mënyrë, imami i mbron pasuesit e tij. Po ashtu, kjo tregon rëndësinë që gjendet në faljen e namazit pas imamit. Por, kur faleni vetëm, duhet të ndiqni shembullin e përkryer të Profetit Muhammed ^{s.a.v.s.}, sahabëve të tij dhe të personaliteteve të shquara të Islamit. Duhet të recitoni shpesh ato ajete të Kuranit Famëlartë që ju ngjallin përlulesi dhe druajtje në mënyrë të veçantë. P.sh. duke recituar el-Fatihane, duhet të përsërisni shumë herë ajetin:

إِنَّا لَكَ نَتَّعِبُ وَإِنَّا لَكَنَّا نَسْتَعِينُ

“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë”.³

Kjo do t'i ngjallë shpirtit një ndjenjë turpi dhe edhe nëse është i zhytur në

mijëra mendime të tjera, shpirti do të kthehet me shpejtësi drejt namazit. Ai do të mendojë se derisa dëshmon se nuk adhuron askënd tjetër përveç Zotit, nuk duhet të lejojë në asnjë mënyrë që mendimet e tij të shpërndahen andej e këtej.

- Kjo metodë u vjen në ndihmë atyre që nuk mund të përqendrohen për një kohë të gjatë. Si fëmijë, që nuk mund të durojë urinë për një kohë të gjatë, apo të përtypë a të tretë ushqim në sasi të madhe, ata gjithashtu kanë nevojë mbështetje të vazhdueshme. Një metodë e dobishme është që ata të përqendrohen vetëm në një pozicion në një çast. P.sh. duke qëndruar në këmbë (Kijam), deri në përkulje (ruke) duhet të tregohen të vendosur, ata duhet të tregojnë vendosmëri për të mos lejuar asnjë mendim deri në përkulje (ruku) që i largon vëmendjen nga namazi. Duke u përkulur, ata sërish duhet të ripërtërijnë vendosmërinë e tyre deri në fund të rukusë. Ata duhet të veprojnë në këtë mënyrë para çdo ndryshimi në lëvizje. Kjo mënyrë do t'u japë fuqi para mendimeve të shpërqendruara.

- Kur njeriu u dorëzohet mendimeve të botës, ato nuk i shqiten më. Por, kur ai u kundërvihet këtyre mendimeve dhe lufton vendosmërisht kundër tyre, ato veniten e zhduken. Prandaj, jepuni një qëndresë të fuqishme këtyre mendimeve dhe ndalojini menjëherë. P.sh. nëse

gjatë namazit, ju mendoni për fëmijën tuaj të sëmurë, largoni këtë mendim, duke i treguar vetes se fëmija nuk bëhet i shëndoshë thjesht nëse e kujtoni e as nuk përkeqësohet nëse nuk e kujtoni. Tregoni vendosmërinë se nuk do ta kujtoni atë gjatë namazit. Përdorni këtë metodë kundër çdo mendimi që ju afrohet, derisa të arrini aftësinë mbizotëruese kundër tyre.

- Kur falni nafile në shtëpi, recitoni fjalët me zë të lartë që t'i dëgjoni vetë. Meqë veshët nuk janë të mbyllur, ata vijnë të funksionojnë pjesërisht. Prandaj, duke dëgjuar fjalët, mendja juaj do jetë më e prirë ndaj kujtimit të Zotit. Në përgjithësi, kjo metodë mund të përdoret vetëm gjatë natës. Nëse vendosni për t'i përdorur veshët gjatë ditës, ata mund të shpërqendrohen nga gjithfarë zhurmash që dëgjohen në mjedis.

- Lëvizjet e reja ngjallin mendime të reja. Por, meqë lëvizjet që bëhen gjatë namazit janë pjesë të qenësishme të adhurimit, ato nuk na prijnë drejt mendimeve të jashtme, ndërsa lëvizjet e tjera na largojnë vëmendjen nga namazi. I Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} ka porositur që gjatë namazit, duhet t'u shmangemi lëvizjeve të panevojshme.

Me të vërtetë, lëvizjet shpërndajnë vëmendjen tonë. Kur dikush rastësisht e prek xhaketen, ai nis të mendojë se ajo është bërë e vjetër, dhe tani i nevojitet

një xhaketë e re. Më pas, ai rreh me mend se si do të sigurojë para për të. Ndoshta, ai rrëmbehet akoma më thellë në vorbullën e mendimeve se sa e vogël është rroga e tij, apo sa e vonuar ishte paga e fundit, ose vonesa e pagës ishte si pasojë e neglizhencës së shefit të tij – dhe se sa i lig është shefi i tij. Pastaj ai humbet në mendime të tjera se si do të hakmerret kundër punëdhënësit, dhe sakaq e dëgjon imamin duke thënë: “Es-salamu alejkum ue Rahmetullah”. Kështu, ai përfundon namazin, pa bërë adhurim të vërtetë.

I Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} ka ndaluar të gjitha lëvizjet e panevojshme që nuk i përkasin namazit. Madje, nëse ka guraleca në vendin e sexhdes, ato nuk duhet hequr përveçse nëse të shkaktojnë dhimbje të padurueshme, por edhe kjo lëvizje duhet bërë vetëm njëherë. Shkurt, njeriu duhet t’u shmanget të gjitha lëvizjeve të panevojshme që nuk kanë lidhje me namaz.

- Kryeni çdo lëvizje të namazit, si Kijam (qëndrim në këmbë), Ruku (përkulje) dhe sexhde me vëmendje të plotë. Mos e vini krejt peshën e trupit mbi njëren këmbë, duke lënë të lirë këmbën tjetër. Nëse jeni të pavëmendshëm, armiku mund t’ju mbizotërojë. Plogështia fizike e çon njeriun drejt plogështisë shpirtërore e mendore.
- Kjo metodë është përdorur nga disa

sufistë por e kanë kaluar masën e nevojshme. Ndonëse mua nuk më pëlqen ekzagjerimi, por ndoshta ndonjë besimtar mund të përfitojë edhe prej kësaj metode.

Hazret Xhunejdi i Bagdadit⁴ ishte një njeri i shenjtë i cili gëzonte një status të lartë shpirtëror. Një ndër nxënësit e tij ishte Shibliu, një njeri i drejtë dhe i sinqertë. Përpara, ai kishte qenë guvernator i një province. Njëherë, ai ndodhej në oborrin e mbretit, teksa mbreti i dhuronte mantelin mbretëror një kryetar fisi si shenjë mirënjohje për shërbimet e tij. Kryetari ishte i ftohur dhe pikërisht në çastin që ai qëndronte para mbretit, i qëllloi t’i binte hunda. Kryetari nuk kishte shami. Prandaj ai priti, dhe kur ishte i bindur se nuk e shikonte mbreti, ai menjëherë e fshiu hundën me veshjen mbretërore. Por, mbreti e kishte vërejtur këtë veprim dhe u mbush me zemërim sepse kryetari e kishte çnderuar veshjen mbretërore. Shibliu, i cili gjithmonë i druhej Zotit, ishte shtangur aq shumë nga kjo ngjarje, saqë i ra të fikët. Kur iu kthyen ndjenjat, ai menjëherë dha dorëheqje nga posti i guvernatorit. Kur e pyeti mbreti për arsyen e dorëheqjes, ai i tha: “Ju kishit dhuruar vetëm një veshje atij kryetari, dhe shfrytëz tërë mllëfin kur ai e çnderoi atë. Zoti më ka falur aq shumë mirësi e bekime dhe mendova se sa i madh do të jetë zemërimi i Tij, nëse i tregohem

mosmirënjohës”.

Pastaj, ai shkoi te Hazret Xhunejdi dhe iu lut që ta pranonte si nxënës. Por Xhunejdi i tha: “Unë nuk mund të të pranoj si nxënës. Ti ke qenë guvernator, dhe në këtë cilësi duhet të kesh sunduar mizorisht ndaj qytetarëve”. Shibliu iu përgjërua: “A ka ndonjë mënyrë për ta shlyer atë që kam bërë?” Xhunejdi e porositi që të trokiste në çdo derë të atij vendi, të kërkonte falje dhe të ofronte shpagim për gabimet e bëra. Shibliu e plotësoi këtë porosi ashtu siç duhej.

Sipas rrëfimeve rreth jetës së tij, sa herë që Shibliu ndiente plogështi apo binte në mendime, që i largonin vëmendje gjatë nafleve, ai i binte vetes me një shkop derisa të këputej. Pastaj vazhdonte sërish me namaz. Në fillim, ai mbante një tufë shkopinjsh pranë vendit ku falej. Mënyra e tij ishte e tepërt që kalonte çdo masë të zakonshme. Sipas botëkuptimit tim, Islami nuk lejon të kalojmë çështje deri në këtë ekstrem. Por, nuk mund t’i bëj kritikë, derisa kjo mënyrë i përkiste vetëm atij.

Ndërsa për mua, masa disiplinore ndaj nefsit, nuk duhet të jetë kaq e ekzagjuar. Nëse ju shpërndahet vëmendja gjatë namazit, identifikoni pjesën që ishit duke kryer kur ju pushtuan mendimet e tjera dhe filloni namaz përsëri pikërisht prej asaj pjese. Në këtë mënyrë, vetë qenia juaj do të realizojë se jeni i

vendosur dhe i palëkundshëm në adhurimin e Zotit. Ky vetëdijesim do të largojë turbullimin e mendimeve dhe do t’ju mundësojë të arrini paqe dhe përqendrim.

- Ka edhe një metodë tjetër të dobishme. Kurani Famëlartë përshkruan një cilësi të besimtarëve me këto fjalë:

وَالَّذِينَ هُمْ عَنْ اللَّغْوِ مُعْرِضُونَ

“Ata u shmangen veprimeve të padobishme”.⁵

Njerëzit që kanë zakon të jepen pas mendimeve të kota dhe të pavlera, u dorëzohen të tilla mendimeve edhe gjatë namazit. Nëse arrijnë të edukojnë veten për t’u çliruar plotësisht nga gracka e këtyre mendimeve, ata edhe përgjatë namazit mund të ruhen nga shpërqendrimi i vëmendjes. Shumëkush jepet pas të tilla mendimeve si legjendat e Nastradinit. Kjo mënyrë e të menduarit nuk u sjell asnjë dobi, andaj ata nuk duhet të lejojnë që mendja të veprojë në mënyrë hipotetike e të përciptë. Padyshim, nuk ka asnjë të keqe në të menduarit për çështjet që janë të dobishme e të nevojshme. Por, është kulmi i injorancës, nëse njeriu hidhërohet duke menduar për çështjet që i përkasin së kaluarës, të cilat ai nuk i ndryshon dot.

Është e qartë, që përpjekjet njerëzore përqendrohen në ato çështje që u dikton mendja. Kur njeriu e lodh mendjen

vetëm në punë të kota e të pavlera, i ikën aftësia për t'u fokusuar edhe në çështje të dobishme. Prandaj, ndaloni mendimet e pavlera dhe kushtojuni vëmendje ideve të frytshme. Kur veproni në këtë mënyrë, mendja do të përvetësojë vetinë për t'iu kushtuar gjithmonë punëve të dobishme. T'u kushtoni vëmendjen çështjeve të tjera, ndërkohë që jeni angazhuar në një punë, përveç disa rasteve specifike, është një praktikë e padobishme. Njeriu, i cili e ka stërvitur mendjen të përqendrohet vetëm në punë të dobishme, nuk mendon për çështje të tjera gjatë namazit.

- Kjo metodë mjaft e dobishme e ngre spiritualitetin një nivelin më të lartë. Njëherë i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} është pyetur se çfarë është Ihsani (mirësia)? Ai u përgjigj:

“الإحسان أن تعبد الله كأنك تراه، فَإِنْ لَمْ تَكُنْ تَرَاهُ فَإِنَّهُ يَرَاكَ”

“Ihsani është të adhurosh Allahun sikur e sheh. Atë ose të paktën të vetëdijesohesh se Ai të sheh ty”.⁶

Kur jeni duke adhuruar Allahun, mendoni sikur qëndroni në praninë e Tij dhe që ju mund ta shikoni Atë, jo në trajtën fizike por në lavdinë dhe madhështinë e Tij. Ky përfytyrim i ngjall mendjes një frikë prej madhështisë dhe fuqisë së Zotit dhe ajo bëhet e vetëdijshme për të mos bërë asgjë të papërshtatshme. Nëse nuk jeni në gjendje ta përfytyroni Zotin, të paktën

besoni se Ai ju sheh juve. Ai është absolutisht i Gjithëdijshëm mbi atë që kalon në mendjen tuaj. Duhet të rishikoni me vëmendje se kur shqiptoni fjalët “*El-hamdu-lil-lah*” (Lavdia është e Allahut), gjendja juaj shpirtërore gjithashtu a i përgjigjet kësaj ndjesie në të njëjtën mënyrë ose është kapluar nga mendimet krejtësisht të kundërta? Duhet t'i hiqni vërejtje mendjes, nëse ajo i drejtohet kahut të kundërt, dhe bëjeni që zemra t'i bashkohet asaj që shqiptohet nga goja.

I Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} ka thënë që besimtari i cili fal dy rekate me një përkushtim dhe përqendrim të tillë, saqë nuk përfshihet në asnjëlloj bashkëbisede me vetveten, lirohet nga barra e mëkateve. Paramendoni pozitën e atij njeriu, i cili gjithmonë qëndron në këtë gjendje!! Andaj, përqendrimi i plotë ndaj Zotit në namaz nuk është një çështje e rëndomtë.

Këto metoda që ju kam shtjelluar me mirësinë e Zotit, nuk duhen trajtuar me shpërfillje. Nëse ju do të mundoheni sinqerisht për t'i zbatuar ato, do të gëzoni bekime të panumërta.

Në fund të namazit, ne themi përshëndetjen e njohur islame “*Es-selamu alejkum ve rahamtullahi ve berakatuhu*”. Kjo është një treguese e shkëlqyer për ruajtjen e përqendrimit. Ju thoni “*Selam alejkum ...*” kur vini nga

jashtë. Kur një musliman përsëndet duke thënë “*Es-Selamu alejkum ve rahmetullah*” në mbarim të namazit, ai në njëfarë mënyre tregon se kishte shkuar për t’i shprehur bindje dhe nënshtrim Allahut dhe është kthyer tashmë. Ai dëshmon se ka sjellë bekimet dhe mesazhin e paqes për vëllezërit e tij muslimanë. Por, meqenëse ai gjatë kësaj kohe fizikisht aty ishte, prandaj i vetmi kuptim që ata mund të nxjerrin është që shpirti i tij po përkulej në praninë e Zotit. Ai ishte kredhur aq shumë në lutje, sikur kishte ndërprerë lidhje me botën e jashtme. Vënia e fjalëve “*Es-selamu alejkum ...*” në fund të namazit, tregon se vëmendja për mbrojtjen e namazit është kushti themelor për çdo musliman, sepse gjatë kohës së namazit, ai gjendet në oborrin e Zotit, i Cili ka porositur:

وَقُمْ عَلَى صَلَاتِهِمْ يُحَافِظُونَ

“Ata e ruajnë namazin e tyre”.⁷

Shejtani synon t’ua prishë adhurimin, por muslimanët vigjilentë dhe syhapur mbrojnë namazet e tyre nga sulme të tilla. Çdokush duhet të ruajë namazin e tij. Kur falni namazin, mos harroni se keni hyrë në oborrin e Zotit. Kur dilni prej andej, duhet t’u jepni sihariq atyre që janë në të djathtë e në të majtë, se keni sjellë paqe dhe bekime për ta. Por, nëse dikush nuk ka shkuar kurrë në oborrin e Zotit dhe ka mbetur përherë i zhytur në mendime të veta, gënjen kur thotë “*Es-selamu alejkum ve rahmetullah*”. Ai mundohet t’u tregojë të tjerëve se po kthehej nga Zoti, ndërkohë ai kurrë nuk kishte shkuar tek Ai.

Bëni çdo përpjekje për të ruajtur namazet tuaja. Bëni qëndresë të madhe kundër shejtanit, sepse ai është betuar për t’ju larguar nga Zoti. Mbani mend, nëse namazi juaj mbaron në ballafaqim të vazhdueshëm me shejtanin, dhe ju nuk i dorëzoheni atij, Allahu do t’ju konsiderojë sikur ishit në oborrin e Tij. Por nëse i dorëzoheni shejtanit, do t’ju lërë edhe Zoti. Mos e ndërprisni përpjekjen, sepse në fund do të arrini fitoren.

SHËNIME

1. Shihabudin ‘Umar Es-Suhraverdi (1145-1234) qe sufi dhe mistik persian. Ai studioi fikhun, drejtësinë, teologjinë, shkencat kuranore dhe hadithin. Libri i tij *‘Avārif el-ma’ārif* shumë shpejt u bë ndër librat më të njohur për sufizmin në të gjithë botën. Ky autor të mos ngatërrohet me me autorin pers dhe filozofin Shahabuddin Suhraverdi (1145-1191).

2. “*Sahih el Buhari*”, kitab: “*Es-Salat*”, bab: “*Idha sal-le fi thevbin lehu a’lamun ve nedhare ila ‘alemiha*”, hadithi nr. 373.

3. Kurani Famëlartë 1:5.

4. Xhunejd el-Bagdadi (835-910), mistik persian dhe njëri ndër shenjëtorët më të famshëm të Islamit, të hershëm. Nxënësi dhe ndjekësi më i zellshëm i tij ishte Ebu Bekër Shibli.

5. Kurani Famëlartë 23: 4.

6. “*Sahih el Buhari*”, kitab: “*Et-Tefsir*”, bab: “*In-nall-labe indehu ‘ilmus-sa’ati*”, hadithi nr. 4777.

7. Kurani Famëlartë 6:93.

Çfarë është agjërimi?

Agjërimi është shtylla e dytë kryesore e adhurimeve në fenë islame. Agjërimi është një adhurim që synon ekuilibrin e shpirtit dhe reformimin e tij dhe i shton forcën e durimit. Nëpërmjet kësaj metode pastrimi, agjërimi e sjell njeriun më afër Zotit, si dhe më afër nevojave të krijesave të Tij.

Në arabisht agjërimit i thonë صوم “saum”, që do të thotë “frenim” ose “heqje dorë nga diçka e caktuar”. Në terminologjinë islame, fjala “saum” nënkupton të heqësh dorë nga ushqimi dhe pija dhe nga marrëdhëniet bashkëshortore prej sabahut (agimit të vërtetë) deri në perëndimin e diellit, me qëllim adhurimi ndaj Zotit të Madhërishëm.

Këto janë tri kushte themelore për të kompletuar agjërimin. Heqja dorë për hir të Zotit nga çdo ushqim dhe pije dhe nga marrëdhëniet bashkëshortore, është si shenjë fizike që tregon se jeni gati të ruheni nga çdolloj ligësie. Siç e thotë Profeti Muhammed ^{s.a.v.s.}:

عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ - رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ - قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ " مَنْ لَمْ يَدَعْ قَوْلَ الزُّورِ وَالْعَمَلَ بِهِ فَلَيْسَ لِلَّهِ حَاجَةٌ فِي أَنْ يَدَعَ طَعَامَهُ وَشَرَابَهُ "

“Ai që nuk heq dorë nga gënjeshtria dhe të punuarit me gënjeshtër, Zoti nuk ka nevojë që ai të heqë dorë nga të ngrënët dhe të pirët”.¹ Dhe diku tjetër ai tha:

لَيْسَ الصَّيَامُ مِنَ الْأَكْلِ وَالشَّرْبِ ، إِنَّمَا الصَّيَامُ مِنَ اللَّغْوِ وَالرَّفَثِ ، فَإِنْ سَأَبَكَ أَحَدٌ أَوْ حَمَلَ عَلَيْكَ فَقُلْ : إِنِّي صَائِمٌ

“Agjërimi nuk është vetëm heqja dorë nga të ngrënët dhe të pirët. Agjërimi (i vërtetë) është (shmangia) prej gjërave të padobishme dhe imorale. Nëse dikush të shan apo të provokon, atëherë thuaji: unë jam me agjërëm”.²

Ai që përfshihet në sharje a fjalosje të rëndë duke qenë me agjërëm, agjërimi i tij është vetëm qëndrimi pa bukë e pa ujë, gjë që nuk i sjell dobi aspak, sepse agjërimi nuk do të thotë të rrih pa bukë e pa ujë, por ai është një adhurim që realizohet duke përmbushur disa kushte. Duke mos i përmbushur këto kushte, fatkeqësisht, disa njerëz e privojnë veten nga shpërblimi madhor i agjërimit.

Hazret Ebu Hurejre ^{r.a.} rrëfen se i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} tha:

“عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ - صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ - " رُبُّ صَائِمٍ لَيْسَ لَهُ مِنْ صِيَامِهِ إِلَّا الْخَوْفُ وَرُبُّ قَائِمٍ لَيْسَ لَهُ مِنْ قِيَامِهِ إِلَّا الشَّوْخُ "

“Ka shumë agjërues, që nuk fitojnë asgjë nga agjërimi i tyre përveç etjes dhe urisë dhe ka shumë nga ata që çohen gjatë netëve për namazin e natës, por nuk fitojnë asgjë përveç pagjumësisë”.³

SHËNIME

1. “*Sahih el Buhari*”, kitab: “*Es-saum*”, bab: “*Men lem jeda’ kaulez-zuri vel-’amele bihi fis-saumi*”, hadithi nr. 1903.
2. Ebu ‘Abdullah el-Hakim en-Nishaburi, “*El-Mustedrek ‘Ala es-Sahibajn*”, kitab: “*es-Saum*”, hadithi nr. 1570.
3. “*Sunen Ibn Maxbeh*”, kitab: “*Es-Saum*”, hadithi nr. 1690.